

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6856  
E enjte, 23 mars 2023  
çmimi 0.40 €

Tërnavë bën thirrje  
për paqe në muajin  
e Ramazanit | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## KOSOVA KËRKON NGA BE-ja TA DETYROJË SERBINË T'I ZBATOJË MARRËVESHJET E ARRITURA NË DIALOG | FAQE 4-5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të mërkurën se Bashkimi Evropian ka toleruar refuzimin e vazhdueshëm të Serbisë, duke e rrezikuar kështu procesin e dialogut dhe

paqen në rajon. "Po e inkurajon Serbinë në njëfarë mënyre që të prodhojë krizë pas krize", është shprehur Osmani, duke theksuar se Serbia ende pa u mbushur 24 orë nga pajtimi në Ohër, po jep

deklarata se dialogu nuk ka asnjë vlerë për të. E kryeministri Albin Kurti ka thënë se BE-ja është ajo që duhet të sigurojë që marrëveshjet duhet të zbatohen në terren

### OPINION

PREMTIMET E  
PAREALIZUARA  
TË QEVERISË  
KURTI NË  
FUSHËN E  
DREJTËSISË | F. 6



Përparim GRUDA

### AKTUALE



ZGJEDHJET NË VERI SËRISH NË  
PIKËPYETJE | F. 3

KOSOVA ZBATON SANKSIONET E  
SHBA-SË NDAJ "WAGNER"-it | F. 7

### EKONOMI



NDAHEN 6 MILIONË EURO  
PËR SUBVENCIONIMIN E FATURAVE  
TË RRYMËS | F. 8

LIBURN ALIU FTON KOMPANITË TË  
JAPIN PROPOZIME PËR RRUGËN  
PRISHTINË - MITROVICË | F. 8

### SPORT



BERISHA E RRUDHANI: SYNOJMË  
REZULTAT POZITIV NË IZRAEL | F. 10

**OVLUÇK-ja  
PËRKRAH  
MARSHIN PËR  
DREJTËSI NË  
MBËSHTETJE  
TË ISH-KRERËVE  
TË UÇK-së | FAQE 7**



**LAVDËROHET KURTI, NUMËRON  
SUKSESET E QEVERISJES DUVJEÇARE | FAQE 7**

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Macroni synon që plani për pensione të nisë të zbatohet në fund të vitit

PARIS, 22 MARS - Presidenti francez Emmanuel Macron ka thënë të mërkurën se pret që projektligji për pensionet të hyjë në fuqi “deri në fund të vitit”. Macroni e ka miratuar këtë projektligji pa miratim në parlament. Ai i ka bërë këto komente në një intervistë në transmetuesin kombëtar, duke thënë se projektligji për rritjen e moshës së pensionimit nga 62 në 64 vjeç do ta “vazhdojë rrugën demokratike”.

Këshilli Kushtetues do të duhet ta rishikojë projektligjin në javët në vijim dhe ai mund të shndërrohet në ligj vetëm pasi ky trup ta japë miratimin. Kjo ka qenë hera e parë që Macroni ka folur publikisht prej kur qeveria e ka miratuar atë pa e dërguar në parlament.

Ky vendim ka nxitur protesta të dhunshme në Paris dhe shumë qytete të tjera franceze.

Megjithatë, qeveria u ka mbijetuar dy mocioneve të mosbesimit në parlament të hënën.

Presidenti Macron, 45-vjeçar, ka thënë vazhdimisht se është i bindur që reforma është e domosdoshme në mënyrë që sistemi i pensioneve të mbetet funksional. “Reforma nuk është luks, nuk është për argëtim, është domosdoshmëri për shtetin”, ka thënë ai.

Macroni i ka “dënuar” protestat e dhunshme dhe ka insistuar se “i respekton” sindikatat dhe protestat që janë organizuar nga kundërshtarët e tij, të cilët nuk pajtohen me planin për pensione.

Sindikatat kanë bërë thirrje për protesta mbarëkombëtare të enjten dhe për greva në sektorët kyçë derisa qeveria ta tërheqë këtë projektligj.



## Koreja e Veriut kryen testime të reja të raketave

PHENJAN, 22 MARS - Koreja e Veriut ka lëshuar disa raketa më 22 mars, ka njoftuar ushtria e Seulit. Lëshimi i fundit i raketave vjen në kohën kur Koreja e Jugut dhe Shtetet e Bashkuara po mbajnë stërvitje të përbashkëta ushtarake. “Ushtria e Koresë së Jugut ka detektuar lëshimin e disa raketave në Detin e Lindjes” nga Koreja e Veriut, tha Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë së Seulit, duke iu referuar detit që njihet edhe si Deti i Japonisë. “Detajet specifike po analizohen nga autoritetet e inteligjencës së Koresë së Jugut dhe Shteteve të Bashkuara”, u tha në deklaratë.



Pasi vitin e kaluar Koreja e Veriut testoi një numër rekord të armëve dhe rriti kërcënimin bërthamor, Seuli dhe Uashingtoni kanë rritur

bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe më 13 mars kanë nisur stërvitjet e përbashkëta ushtarake, që janë më të mëdhatë në pesë vjetët e fundit.

Të njohura si Mburoja e Lirisë, stërvitjet do të mbahen për të paktën dhjetë ditë.

Ushtria e Koresë së Jugut tha se do t'i "kryejë me sukses stërvitjet e planifikuara nën një qëndrim të fortë të mbrojtjes”.

Koreja e Veriut i sheh të gjitha stërvitjet ushtarake si përgatitje për pushtim dhe thotë se ato janë “shpallje e luftës”. Phenjani vazhdimisht ka kërcënuar se do të ndërmarë masa të mëdha për t’iu kundërpërgjigjur stërvitjeve ushtarake.

Lëshimet e raketave më 22 mars vijnë një javë pasi Koreja e Veriut testoi raketën më të madhe dhe më të fuqishme, Hwasong-17. Ai ishte testimi i dytë gjatë këtij viti

i një rakete balistike ndërkontinentale.

Media shtetërore verikoreane tha se lëshimi i raketës balistike ndërkontinentale u bë për shkak të stërvitjeve të ShBA-së dhe Koresë së Jugut.

Koreja e Veriut vitin e kaluar e shpalli veten si fuqi “të pakthyeshme” bërthamore dhe lideri verikorean, Kim Jong Un, së fundmi ka kërkuar një rritje “të madhe” të prodhimit të armëve, përfshirë edhe armëve taktike bërthamore.

Gjatë këtij muaji Kim, po ashtu, ka urdhëruar ushtrinë e Koresë së Veriut që t’i shtojë ushtrimet për t’u përgatitur për “një luftë të vërtetë”.


## FMN-ja arrin marrëveshje me Ukrainën për programin prej 15.6 miliardë dollarësh

UASHINGTON, 22 MARS - Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) tha se ka arritur marrëveshje me Ukrainën për financimin katërvjeçar të një pakete në vlerë prej 15.6 miliardë dollarësh, duke i ofruar fonde shtetit që po vazhdon të mbrohet nga pushtimi i Rusisë. Marrëveshja, e cila duhet të ratifikohet nga bordi i FMN-së, ka marrë në konsideratë rrugën e Ukrainës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian pasi të përfundojë lufta. FMN-ja tha se bordi ekzekutiv pritet të miratojë këtë marrëveshje në javët në vijim. “Qëllimet kryesore të programit janë ta mbështetin stabilitetin

ekonomik dhe financiar në rrethana të pasigurisë jashtëzakonisht të lartë, ta rivendosin qëndrueshmërinë e borxhit dhe ta mbështetin rimëkëmbjen e Ukrainës në rrugën drejt pranimin në BE pas mbarimit të luftës”, tha zyrtari i FMN-së, Gavin Grey, përmes një deklaratë për medie.

Stafi i FMN-së ka njoftuar anëtarët e bordit për marrëveshjen, që paraqet pakon e kredisë më të madhe për Ukrainën qëkur Rusia nisi pushtimin e këtij shteti më 24 shkurt 2022.

FMN-ja tha se marrëveshja pritet të ndihmojë në një financim të madh për Ukrainën



nga donatorët ndërkombëtarë dhe partnerët, por nuk dha detaje. Zakonisht, kreditë e FMN-së mundësojnë mbështetje edhe nga Banka

Botërore dhe institucione të tjera financiare.

Sipas përlogaritjeve, kostoja e rindërtimit të Ukrainës vlerësohet të jetë qindra miliarda

dollarë. “Një rimëkëmbje graduale ekonomike pritet gjatë tremujorëve të ardhshëm, pasi aktiviteti rimëkëmbet nga dëmet e mëdha në infrastrukturën kritike, megjithëse ka ende rreziqe të mëdha, përfshirë edhe rrezikun e përshkallëzimit të mëtejshëm të konfliktit”, tha Grey.

Kryeministri i Ukrainës, Denys Shmyhal, mirëpriti marrëveshjen dhe falënderoi FMN-në për mbështetjen.

Nëse miratohet kjo marrëveshje, ashtu siç pritet të ndodhë, programi për Ukrainën do të jetë kredia më e madhe që FMN-ja i ka dhënë një shteti të përfshirë në konflikt aktiv.

# Zgjedhjet në veri sërish në pikëpyetje



## A ka zgjedhje pa favorit zgjedhor? Kjo pyetje është gjithnjë e më e zëshme në veri të Kosovës, pasi Lista Serbe - partia kryesore e serbëve të Kosovës - ka theksuar sërish se do ta bojkotojë procesin zgjedhor

PRISHTINË, 22 MARS - A ka zgjedhje pa favorit zgjedhor? Kjo pyetje është gjithnjë e më e zëshme në veri të Kosovës, pasi Lista Serbe - partia kryesore e serbëve të Kosovës - ka thënë sërish se do ta bojkotojë procesin zgjedhor. Për Dushan Radakoviqin nga Qendra për Përfaqësimin e Kulturës Demokratike në Mitrovicë të Veriut dhe Violeta Haxhollin nga Instituti Demokratik i Kosovës dilema nuk ka. Zgjedhjet e planifikuara për 23 prill, sipas tyre, janë ende në pikëpyetje. Në ditën kur afati për aplikim dhe konfirmim të subjekteve politike dhe të kandidatëve skadon, ata bëjnë thirrje për një marrëveshje urgjente politike. Zgjedhjet e jashtëzakonshme mbahen pasi kryetarët nga radhët e Listës Serbe në komunat në veri - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok - kanë dhënë dorëheqje në fillim të nëntorit të vitit të kaluar për shkak të vendimit të Qeverisë së Kosovës për t'i reregjistruar makinat me targa serbe në targa të Kosovës.

Dorëheqje kanë dhënë edhe serbët e punësuar në gjyqësor, administratë, polici dhe dogana të Kosovës. Zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale janë shpallur fillimisht për 18 dhjetor 2022, por me kërkesë të bashkësisë ndërkombëtare janë shtyrë vetëm dhjetë ditë para mbajtjes së tyre. Lista Serbe edhe atëherë ka refuzuar pjesëmarrjen, edhe pse Qeveria e Kosovës e ka pezulluar vendimin për reregjistrimin e makinave në bazë të një marrëveshjeje me Serbinë. A ka kushte për mbajtjen e zgjedhjeve? "Radio Evropa e Lirë" e ka pyetur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nëse ka kushte për mbajtjen e zgjedhjeve në komunat me shumicë serbe në veri dhe a ka mundësi të shtyhen sërish ato nëse nuk ka kandidatë nga komuniteti serb, por nuk ka marrë përgjigje. Megjithatë, në mes të marsit, KQZ-ja ka njoftuar se subjektet politike dhe kandidatët e konfirmuar në nëntor për pjesëmarrje në zgjedhjet e 18

dhjetorit 2022 e kanë konfirmuar tashmë pjesëmarrjen dhe se nuk kanë nevojë të aplikojnë më. Asokohe kanë qenë 11 kandidatë nga katër subjekte politike, prej të cilëve vetëm dy kanë qenë të komunitetit serb.

### A mund të shtyhen zgjedhjet?

Dushan Radakoviq thotë se pa ndonjë marrëveshje të shpejtë politike, është mjaft e sigurt që zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale në veri të shtyhen, "me shumë gjasë për në qershor". Ai argumenton se serbët janë larguar edhe nga komisionet komunale zgjedhore dhe se, thjesht, nuk ka kush ta organizojë të gjithë procesin. Një problem tjetër, sipas tij, është se pa marrëveshje politike Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës nuk do të ketë ku t'i hapë vendvotimet. "Pa ndonjë marrëveshje serioze politike dhe pjesëmarrjen e kandidatëve serbë kam frikë se nuk do të ketë proces zgjedhor", thotë Radakoviq për "Radion Evropa e Lirë". Deri më tash praktikë ka qenë që vendvotimet të hapen në institucionet arsimore, por ato në zonat serbe funksionojnë në sistemin serb, kështu që ka mundësi që drejtorët të mos lejojnë që të shfrytëzohen objektet e tyre. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pas një takimi me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, më 18 mars në Ohër, ka thënë se zgjedhjet në veri mund të shtyhen për në qershor. "Nuk

do të flas në emër të Listës Serbe. Thjesht, duhet të flas me ata njerëz. Duhet të shoh nëse [zgjedhjet] duhet të mbahen tani apo në qershor. Do të shohim", ka thënë Vuçiq.

### Pse Lista Serbe refuzon të marrë pjesë në zgjedhje?

Dy ditë pas kësaj deklarate të presidentit serb, Lista Serbe ka përsëritur qëndrimin e saj të mëparshëm se nuk do të marrë pjesë në zgjedhje derisa të plotësohen kërkesat e saj, që janë: formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë dhe tërheqja e të gjitha njësive speciale të Policisë së Kosovës nga veriu. Çështja e formimit të Asociacionit duhet të zgjidhet me Marrëveshjen drejt normalizimit, të mbështetur nga BE-ja, të cilën e kanë pranuar Kosova dhe Serbia. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar më 21 mars se "do të duhet të merremi me atë formulim sa i përket vetëmenaxhimit për komunitetin serb". Vetëmenaxhimi për komunitetin serb në Kosovë është paraparë me Marrëveshjen drejt normalizimit, por ende nuk dihet se për çfarë saktësisht bëhet fjalë. Për Asociacionin, ndërkaq, Kosova dhe Serbia janë pajtuar në vitin 2013. Ai parashihet që serbët e Kosovës të kenë "juridiksion të plotë" në fusha të caktuara, si: planifikimi hapësinor, shëndetësia, arsimit, zhvillimi

ekonomik e kështu me radhë. Kurti në disa raste ka përsëritur se Kosova nuk mund ta lejojë formimin e asociacioneve njëetnike sepse, sipas tij, të tillat rrezikojnë funksionalitetin e shtetit.

### A është opion marrëveshja në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Listës Serbe?

Violeta Haxhollin shpreh shqetësimin e saj se Lista Serbe sërish nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje dhe shton se autoritetet e Kosovës "duhet urgjentisht të krijojnë komunikim me të". Ajo vlerëson se Lista Serbe "po i bojkoton zgjedhjet për arsye politike" dhe se, në këtë kontekst, e vetmja zgjidhje është marrëveshja politike. "Pa pjesëmarrjen e saj [Listës Serbe] zgjedhjet nuk kanë asnjë kuptim. Lista Serbe ka fituar shumicën e votave të komunitetit serb në Kosovë dhe komuniteti serb duhet ta ketë si opion për ta votuar", thotë Haxhollin. Lista Serbe ka fituar më shumë se 90 për qind të votave në proceset e mëparshme zgjedhore por, në vitin 2021, BE-ja ka vlerësuar se kjo parti e ka "monopolizuar" jetën politike të serbëve të Kosovës. REL-i ka pyetur në Qeverinë e Kosovës se a po bëhen negociata politike për pjesëmarrjen e Listës Serbe në zgjedhjet e ardhshme dhe nëse ato janë opion, por deri në publikimin e këtij teksti nuk ka marrë përgjigje.



# Kosova kërkon nga BE-ja ta detyrojë Serbinë t'i zbatojë marrëveshjet e arritura në dialog

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të mërkurën se Bashkimi Evropian ka toleruar refuzimin e vazhdueshëm të Serbisë, duke e rrezikuar kështu procesin e dialogut dhe paqen në rajon. “Po e inkurajon Serbinë në njëfarë mënyre që të prodhojë krizë pas krize”, është shprehur Osmani, duke theksuar se Serbia ende pa u mbushur 24 orë nga pajtimi në Ohër, po jep deklarata se dialogu nuk ka asnjë vlerë për të. E kryeministri Albin Kurti ka thënë se BE-ja është ajo që duhet të sigurojë që marrëveshjet duhet të zbatohen në terren

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 22 MARS** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë me dije se ka pasur takime të vazhdueshme me kryeministrin Albin Kurti sa i përket takimit në Ohër. Osmani ka theksuar se Kurti i janë propozuar dokumente të tmerrshme që, sipas saj, Kosova ka bërë mirë që nuk i ka pranuar. “Me kryeministrin jemi takuar siç takohemi gjithnjë, edhe para takimit të kryeministrin në Bruksel, edhe pas kthimit, jemi takuar dhe kemi diskutuar në detaje para se të shkoj në Ohër. Jemi konsultuar edhe gjatë takimeve në Ohër, dhe jemi takuar edhe pasi ka përfunduar dakordimi në Ohër, ku jemi njoftuar në detaje jo vetëm

për dokumentet dhe versionet e ndryshme që kanë qenë para kryeministrin dhe delegacionit të Kosovës. Dhe më duhet të them se ato janë versione të tmerrshme të cilat Republika e Kosovës ka bërë mirë që nuk i ka pranuar pavarësisht prej presioneve jashtëzakonisht të padrejta që e kanë trajtuar Kosovën në mënyrë shumë të pabarabartë në raport me palën tjetër”, ka thënë Osmani. Këto komente Osmani i ka bërë gjatë vizitës në Klinikën e Gjinekologjisë.

Presidentja ka treguar se për të janë të papranueshme iniciativat e tilla nga faktori ndërkombëtar. “Nganjëherë për mua si presidente është vështirë të besoj që dikush nga komuniteti ndërkombëtar e merr një

iniciativë të tillë që të propozojë gjëra të tilla që e vendos vetëm njëherë palë në një pozitë kaq të pabarabartë”, ka theksuar Osmani. Ajo ka shtuar se aneksi për zbatimin e marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve ka shumë paqartësi. “Aneksi ka lënë shumë gjëra të paqartësuar. Është dashur të paraqes në detaje si do të zbatohen edhe pikat e tjera, si do të jenë penalizimet pastaj për moszbatim ta zëmë të nenit 4 nga ana e Serbisë e shumë gjëra të tjera. BE-ja e ka toleruar refuzimin e vazhdueshëm të Serbisë, që mendoj si qasje po e rrezikon procesin e dialogut dhe paqen në rajon, sepse po e inkurajon Serbinë në njëfarë mënyre që të prodhojë krizë pas krize”, është shprehur Osmani.

Osmani ka thënë se pala serbe vazhdon të mos e respektojë asnjë marrëveshje.

E para e shtetit, duke përmendur nen për nen, ka thënë se të gjitha do të mbesin në fuqi. “Serbia akoma pa u mbushur 24 orë nga dakordimi në Ohër, siç ndodhi edhe në shkurt, po ndodh edhe në mars, tregoi atë që dialogu nuk ka asnjë vlerë për të, as politike e as juridike. Rrjedhimisht e njoftoi bashkësinë ndërkombëtare që nuk do t'i zbatojë ato të cilat qartë dalin nga marrëveshja bazë dhe aneksi”, ka thënë Osmani.

Presidentja e vendit i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar që ta drejtojë “presionin mbi Serbinë” që t'i respektojë obligimet që ka marrë nga marrëveshja bazë e arritur në Bruksel më 27 shkurt, dhe nga aneksi, për të cilën palët u pajtuan në Ohër më 18 mars. “Mendoj se të gjitha përpjekjet, i gjithë presioni, angazhimi i komunitetit ndërkombëtar, duhet të jetë pikërisht te [presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiqi, që ato për të cilat ai është dakorduar, që në esencë përbëjnë njohje de facto të Kosovës - sepse kur ia njih dikujt sovranitetin, kur e njih si të

barabartë në relacionet ndërshtetërore, kur ia njih dikujt integritetin territorial, këto janë elementet shtetërore të shtetësisë. E vetmja që mungon është një letër njohjeje të cilën nuk e ka nënshkruar”, ka thënë Osmani, duke shtuar se: “Por përderisa Vuçiqi refuzon t'i zbatojë këto, atëherë kjo vërtet rrezikon gjithçka. Shpresoj shumë që do të ketë penalizim të qartë nga komuniteti ndërkombëtar për Serbinë”.

Osmani ka thënë se presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiqi, ka shkelur nenin 4 të marrëveshjes, që thotë se Serbia nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Vuçiqi ka deklaruar se Serbia nuk do të respektojë pjesë të marrëveshjes sa i përket anëtarësimin eventual të Kosovës në Kombet e Bashkuara dhe as nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës. Sipas presidentes Osmani, teksti i marrëveshjes drejt normalizimit nuk ndryshohet dhe do të mbetet në fuqi pavarësisht se palët nuk e kanë nënshkruar atë. Presidentja Osmani foli edhe për

## Arrestohen 20 të dyshuar për shpërndarje të drogës në Tiranë

**TRIANE, 22 MARS** - Në operacionin anti-drogë të koduar "Harta", në Shqipëri janë arrestuar 20 persona të dyshuar për shpërndarje të drogës, kryesisht afër shkollave të mesme dhe lokaleve të natës në Tiranë. Kështu tha drejtori i policisë së

Tiranës, Tonin Vocaj, i cili shtoi se të arrestuarit janë pjesë e dy grupeve kriminale, të cilët komunikojnë me mesazhe të koduara dhe përdornin automjete të transportit publik për t'i shmangur kontrollet e policisë.

Gjatë këtij operacioni u sekuestruan dy kilogramë e 120 gramë kokainë, 300 doza kanabis, 130 doza heroinë, rreth 7 mijë euro para të gatshme dhe 11 automjete. Mes të arrestuarve janë edhe tri gra, ndërkohë policia ka

shpallur në kërkim katër persona të tjerë. Raporti i fundit i Institutit të Shëndetit Publik tregon se 5-7 për qind e personave të moshës 15-18 vjeçe kanë eksperimentuar me kanabisin, rreth 4 për qind e tyre me

ekstazi, mbi 1 për qind me heroinë dhe rreth 2-3 për qind e të rinjve kanë eksperimentuar me kokainë. Në këtë raport drogat u janë ofruar më shumë se 8 për qind të të rinjve në mjediset e shkollave.



nenin 7 të marrëveshjes që kërkon sigurimin e një "niveli adekuat të vetëmenaxhimit për komunitetin serb". Sipas saj, ndërkombëtarët po e interpretojnë këtë nen si "zbatim i obligimeve që Kosova ka marrë më 2013", përkatësisht për marrëveshjen për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Kjo për mua si presidente e Republikës nënkupton respektim të plotë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ashtu siç kam thënë nga viti 2015 e tutje. Bashkimi i komunave ose qytetarëve në asociacione është e drejtë që Kosova tashmë e njeh me Kushtetutën e saj", ka deklaruar Osmani, duke shtuar se ky nen mund të zbatohet vetëm përmes vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2015.

### Kurti: Nuk mund të barazohet fjala komunitet me Asociacion

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se në marrëveshjen për normalizimin e

raporteve me Serbinë flitet për arritjen e një niveli "adekuat të vetëmenaxhimit të komunitetit serb" e jo për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Kurti u përgjigj kështu për gazetaret kur u pyet ta komentonte deklaratën e emisarit evropian për dialogun, Mirosllav Lajçak, i cili në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" më 21 mars, tha se neni 7 i marrëveshjes drejt normalizimit, nuk përfshin zotime të reja për Kosovën, por nënkupton krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Nuk mund të barazohet fjala komunitet me komunë, as me fjalën Asociacion, ashtu siç nuk mund të barazohet fjala popull me fjalën Republikë", ka thënë Kurti pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës.

Kosova dhe Serbia më 27 shkurt u pajtuan për marrëveshjen drejt normalizimit, apo që njihet ndryshe edhe si propozimi evropian. Ndërkaq, më 18 mars, palët u pajtuan për aneksin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Në nenin 7 të marrëveshjes,

kërkohej të sigurohet "një nivel i përshtatshëm i vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë". Pavarësisht se ky formulim duket se është referencë për Asociacionin, në tekstin e marrëveshjes nuk përmendet Asociacioni në mënyrë eksplicite. "Në pikën 7 të marrëveshjes bazë thuhet një 'nivel adekuat i vetëmenaxhimit të komunitetit serb'. Thuhet komuniteti serb, e jo komunave. Komuniteti nuk është kategori territoriale. Komunitat janë njësi territoriale dhe administrative, por nuk është e njëjta gjë. Unë e kuptoj që s'janë krejtësisht të ndryshme, të palidhura, por nuk janë e njëjta gjë", ka deklaruar Kurti.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Duke i komentuar deklaratat e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili tha më 21 mars se

Beogradi nuk do të zbatojë pjesë të marrëveshjes që thonë se nuk do të pengohet anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare, Kurti tha se BE-ja "duhet të dëshmohej tani" që marrëveshja të respektohet. "Ne kemi marrëveshje, kishim marrëveshje më 27 shkurt, bëmë sërish marrëveshje më 18 mars dhe që të dyja janë marrëveshje. BE-ja po thotë që është marrëveshje, në anën tjetër keni deklarata të palës serbe e cila tregon se si nuk e ka ndër mend të zbatojë diçka apo se si tashmë po shkel diçka tjetër. Por, ne nuk do të mund të merremi me këtë, andaj ekziston ndërmjetësuesi. Tash BE-ja është ajo që duhet të sigurojë që marrëveshjet e dakorduara duhet të zbatohen në terren. Nuk ka kuptim që marrëveshjet të ngelen tekst në letër, pa ndryshuar realitetin e qytetarëve. Është ndërmjetësi ai që imponon zbatimin ose konstaton moszbatim, shkelje apo sanksione përkatëse. Është ndërmjetësi ai që e ka fjalën tash për çfarëdo devijim, deformim

apo shkelje", tha Kurti. Kosova dhe Serbia më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut arritën pajtim për Aneksin e zbatimit të Marrëveshjes drejt normalizimit. Palët nuk e nënshkruan marrëveshjen, por BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara kanë thënë se, pavarësisht se nuk është nënshkruar, ajo është marrëveshje e obligueshme për palët. Marrëveshja prej 11 nenesh nuk përmend në mënyrë specifike njohjen e ndërsjellë. Megjithatë, dokumenti kërkon nga të dyja vendet që t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njera-tjetres, përfshirë: pasaportat, diplomatat dhe targat. Dokumenti kërkon nga palët, po ashtu, t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tash në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të cilin Qeveria Kosovës e ka refuzuar deri më tash, me arsyetimin se mund ta rrezikojë funksionalitetin e shtetit.

## Humolli edhe zyrtarisht largohet nga grupi parlamentar i LV-së

PRISHTINË, 22 MARS - Deputeti Fatmir Humolli është larguar përfundimisht nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje. Në seancën e


Kuvendit të mërkurën, Humolli është parë i ulur në karriget e opozitës. Për dallim nga herët e tjera, ai është ulur larg grupit parlamentar të

Lëvizjes Vetëvendosje. Në këndin ku ai po qëndronte, në fund të sallës, është parë shefja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza

Kusari-Lila, duke biseduar me të. Pak minuta më vonë, Humollit i ka shkuar edhe deputetja tjetër e LV-së, Shqipe Selimi.



## Premtimet e parealizuara të qeverisë Kurti në fushën e drejtësisë



### Përparim GRUDA

Sot është dyvjetori i zgjedhjes së Qeverisë Kurti II. Asnjë nga premtimet kryesore që janë dhënë për fushën e drejtësisë nuk janë realizuar.

**1. Padia për gjenocid:** Është premtuar se do të ngrahet padi për gjenocid ndaj Serbisë. Pas dy vjetëve mandat, qeveria nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim. Përkundrazi, kryeministri Kurti është pajtuar për të nënshkruar

një marrëveshje me Serbinë e cila parashikon që e kaluara jonë të tejkalohej dhe, po në këtë kohë, është përkujtuar vdekja e kriminelit të luftës, Oliver Ivanoviq dhe është glorifikuar ish-kryeministri i Serbisë, Zoran Gjingjiq. Nga ana tjetër nuk është thënë asnjë fjalë për t'i mbrojtur themeluesit e UÇK-së që po gjykohen në Hagë.

**2. Vetingu:** Është premtuar realizimi i vetingut brenda këtij mandati qeveritar. Ende nuk ka filluar. Për këtë proces janë

shpenzuar dy vjet kohë nga Ministria e Drejtësisë pa asnjë rezultat. Komisioni i Venecias ka gjetur shumë vërejtje në Koncept-dokumentin për Vetingun dhe amandamentet kushtetuese të përgatitura nga kjo ministri. Puna për realizimin e vetingut ka filluar vetëm para pak muajve, kur është themeluar Komisioni i Posaçëm Parlamentar për këtë proces, i propozuar nga PDK-ja. U premtua reformimi i sistemit të drejtësisë, ndodhi e kundërta. U ulën pagat e gjyqtarëve dhe

prokurorëve në mënyrë kundërkushtetuese dhe në kundërshtim me standardet e Komisionit të Venecias.

**3. Skandali i zhdukjes së mostrave të rastit Dehari:** Historia e keqpërdorimit të vdekjes tragjike të Astrit Deharit ka vazhduar edhe këto dy vjet sa LV është në pushtet. Premtimi për ta zbardhur të vërtetën e këtij rasti është mbuluar nga skandali i zhdukjes së mostrave të Astrit Deharit në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë. Asnjë

sqarim për këtë skandal dhe asnjë dorëheqje, mbi të gjitha asnjë hap i bërë për ta zbardhur të vërtetën e plotë të këtij rasti.

**4. Lufta kundër krimit dhe korrupsionit:** Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit flet për korrupsionin qeveritar dhe për mungesën e luftës kundër krimit.

*(Autori është koordinator i Departamentit për Drejtësi në kuadër të Kabinetit për Qeverisje të Mirë (KQM) në PDK)*

## Abdixhiku e njofton Szunyogin për qëndrimet e LDK-së për dialogun dhe reformën zgjedhore



PRISHTINË, 22 MARS - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka pritur të mërkurën në takim shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, përfaqësuesin e posaçëm të BE-së, ambasadorin Tomas Szunyog. Gjatë takimit Abdixhiku e njoftoi ambasadorin Szunyog për

qëndrimet e LDK-së mbi procesin e dialogut.

Në takim u diskutua edhe për reformën zgjedhore dhe konsensusin partiak në Kosovë për këtë çështje; për kontributin e çmueshëm të LDK-së në procesin e vetingut si dhe për zhvillimet e tjera në

Kuvendin e Kosovës. Abdixhiku ka falënderuar ambasadorin Szunyog për rolin mbështetës të Bashkimit Evropian ndaj Republikës së Kosovës dhe reformave të ndryshme të ndërmarra në partneritet me asistencën e BE-së.

## Kuvendi miraton raportin vjetor të KQZ-së për vitin 2021

PRISHTINË, 22 MARS - Kuvendi i Kosovës ka miratuar të mërkurën raportin vjetor të

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për vitin 2021.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka njoftuar se nga 68 deputetë sa ishin në sallë, 67

prej tyre kanë votuar për, ndërsa vetëm një ka abstenuar.



## OVLUÇK-ja përkrah marshin për drejtësi në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 MARS - Organizatorët e platformës "Liria ka emër" kanë vizituar të mërkurën Organizatën e Veteranëve të UÇK-së në Prishtinë. Qëllimi i kësaj vizite ishte kërkesa për ta përkrahur marshin solidarizues në mbështetje të luftës së UÇK-së dhe ish-krerëve të saj. Ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se si organizatë do ta përkrahin këtë marsh, pasi e konsiderojnë se në Hagë nuk ka drejtësi, por padrejtësi. "Kishim një takim me platformën 'Liria ka emër', e cila do të organizojë një marsh për drejtësi në mbështetje të shokëve tanë që i kemi në Hagë. Siç e dini edhe ju, kanë ndodhur shpeshherë padrejtësi dhe marshi ka kuptim që ajo

padrejtësi të vijë në vend dhe të bëhet drejtësi, për shkak se krerëve të UÇK-së dhe ish-luftëtarëve të tyre në shumë raste u janë mohuar shumë të drejta dhe atje nuk po gjykohen si individë, por është duke u gjykuar Ushtria Çlirimtare e Kosovës", ka thënë Klinaku. Klinaku ka thënë se si OVLUÇK-ja do të përkrahë dhe do t'u bëjë thirrje edhe qytetarëve që të marrin pjesë në këtë marsh pasi, sipas tij, është marsh për drejtësi. Ideatori i platformës "Liria ka emër", Ismail Tasholli, ka falënderuar Organizatën e Veteranëve për përkrahjen në marshin që mbahet të dielën më 2 prill në Prishtinë. "Ishte shumë e rëndësishme të ndodhemi sot këtu, te Shoqatat e Dala nga Lufta, sepse këto janë trashëgimia praktike dhe simbolike e të kaluarës shumë të



dinjitetshme. Ne kemi hasur në mbështetje të plotë në kuptimin e bashkëngitjes së marshimit që

kemi organizuar dhe kemi hasur në mirëkuptim dhe shpeshojmë që edhe komunitetet e tjera të

caktuara të jenë pjesë e këtij marshi që ka për qëllim drejtësinë", ka thënë Tasholli.

## Kosova zbaton sanksionet e ShBA-së ndaj "Wagner"-it

PRISHTINË, 22 MARS - Kosova ka përditësuar vendimin për sanksione ndaj grupit rus të mercenarëve "Wagner", duke e përshtatur me vendimin e Shteteve të Bashkuara, e cila në janar e shpalli "Wagner"-in "organizatë të rëndësishme kriminale transnacionale".

Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se ky grup mercenarësh po "kërcënon dhe minon" sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës.

Qeveria miratoi plotësimin e vendimit të 16 majit të vitit 2022, që parashikonte sanksione ndaj "Wagner"-it bazuar në një vendim të Këshillit të Bashkimit Evropian.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se pushtimi i Rusisë kundër Ukrainës, që nisi në



shkurt të vitit 2022, "ka hasur në rezistencën e shtetit dhe popullit të

Ukrainës", por është dënuar nga shtetet demokratike.

"Departamenti amerikan i Thesarit më 26 janar të këtij viti ndërmoi masa kufizuese ndaj grupit 'Wagner' si një organizatë kriminale transnacionale, duke përfshirë edhe rrjetin global të 'Wagner'-it, sektorin ushtarak të Rusisë dhe miqtë e [presidentit rus, Vladimir] Putinit. Këto sanksione u ndërmoren për t'i degraduar kapacitetet e Federatës Ruse për të zhvilluar luftë kundër Ukrainës, duke sanksionuar edhe tetë individë, 16 subjekte dhe katër avionë. Për këtë arsye, Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës propozon plotësimndryshimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës [të 16 majit 2022] për zbatim të sanksioneve ndërkombëtare të vendosura nga ShBA-ja, e që zbatohen nga ana e Republikës sonë në raport me obligimet ndërkombëtare kundër

grupit Wagner si dhe ndaj bashkëpunëtorëve të tyre dhe kompanive të tjera që mbështetin fushatën ushtarake ruse", ka thënë Bislimi.

Që nga nisja e pushtimit të Ukrainës, Kosova ka vendosur sanksione ndaj Moskës, duke ndjekur vendimet e marra nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Grupi Wagner është i përfshirë aktivisht në luftën në Ukrainë dhe, së fundmi, mercenarët e tij po konsiderohen si një forcë e rëndësishme në përpjekjet ruse për ta marrë kontrollin e qytetit lindor ukrainas të Bahmutit. Përveçse ka vendosur sanksione ndaj Rusisë, Kosova ka ofruar mbështetje për Ukrainën, duke strehuar përkohësisht disa gazetarë ukrainas.

## Tërnava bën thirrje për paqe në muajin e Ramazanit

PRISHTINË, 22 MARS - Myftiu i Kosovës, Naim Tërnava, u ka uruar besimtarëve myslimanë agjërim të lehtë në prag të nisjes së Muajit të Ramazanit teksa ka bërë thirrje për paqe në botë.

Besimtarët myslimanë në mbarë botën më 23 mars nisin shënimin e Muajit të Ramazanit.

Myftiu Tërnava tha se agjërimi e afron besimtarin me krijuesin, e largon nga "egoja, urrejtja e smira" dhe e "motivon për punë e vepra të mira". "Në këtë natë të madhe, në vigjilje të fillimit të këtij muaji të madh, lusim Zotin që sa më parë të ndalen luftërat e konfliktet dhe popujt të jetojnë të qetë dhe në paqe e harmoni. Misioni i njeriut në botë nuk është të krijojë trazira, gjakderdhje, vuajtje e shkatërrime, por të jetojë me dinjitet ashtu siç na ka udhëzuar krijuesi i gjithësisë", ka thënë Tërnava.

Myftiu i Kosovës tha se përmes agjërimit gjatë muajit të Ramazanit

besimtarët shfaqin bindjen, dashurinë dhe sinqeritetin ndaj Zotit. "Gjatë ditëve dhe netëve të Ramazanit, shtëpitë tona, rrugët e xhamitë tona gjallërohen e mbushen plot gëzim, rahmet e begati, sepse vetë agjërimi e bën besimtarin më të qetë, e fisnikëron dhe e bën më dorëlibër e më solidar. Muaji Ramazan, si asnjë muaj tjetër, na afron me familjen e fafesisin rreth sofrës së iftarit - moment ky që është i veçantë e në të cilin ka shumë bereqete dhe shumë dashuri. Po ashtu, gjatë këtij muaji jemi më pranë dhe në mbështetje të njëri-tjetrit", ka theksuar Tërnava.

Muaji i Ramazanit nis më 23 mars dhe do të zgjasë për 30 ditë, deri më 20 prill.

Gjatë kësaj periudhe besimtarët myslimanë përmbahen nga ngrënia dhe pirja që nga lindja e diellit deri në perëndim në shenjë sakrifice dhe përkushtimi ndaj



Zotit. Pas përfundimit të Ramazanit,

besimtarët në mbarë botën festojnë Fitër Bajramin, një prej dy

festave më të mëdha të besimit islam.

## Ndahen 6 milionë euro për subvencionimin e faturave të rrymës

PRISHTINË, 22 MARS - Qeveria e Kosovës ka miratuar propozimin e Ministrisë së Financave për ndarjen e 6 milionë euro për subvencionim të faturave të energjisë elektrike për amvisëritë që kanë ulur konsumin krahasuar me muajt përkatës të vitit paraprak. Vendimi është miratuar të mërkurën në mbledhjen e

qeverisë. “Në kuadër të subvencionimit të energjisë elektrike bëjmë ndarjen e radhës në shumën 6 milionë euro në mënyrë që të vazhdohet subvencionimi i atyre që kanë kursyer energjinë elektrike”, ka thënë ministri i Financave, Hekuran Murati. Masa 3.7 e Pakos për Ringjallje Ekonomike parashihet të mbështetjen e qeverisë për

tejkalimin e krizës energjetike. “Amvisëritë të cilat ulin konsumin e energjisë elektrike krahasuar me muajt përkatës të vitit paraprak e që kualifikohen për përfitim, mbështeten me subvencionim të faturës së energjisë elektrike në raport me kursimin, duke filluar nga fatura e muajit shtator 2022”, thuhet në Pakon për Ringjallje Ekonomike.



# Lavdërohet Kurti, numëron sukseset e qeverisjes dyvjeçare



## Emërohet Bordi i Drejtorëve i Infrakosit

Qeveria në mbledhjen e fundit ka emëruar edhe Bordin e Drejtorëve të ndërmarrjes publike Infrakos. Kryesuese është zgjedhur Edona Nahi. “Edona Nahi kryesuese, Genc

Hyndozi anëtar, Besarta Uka anëtare dhe Fitim Rraci anëtar”, ka thënë kryeministri Albin Kurti. Po ashtu, janë miratuar dy marrëveshje

ndërkombëtare për marrje të kredive. Njëra për zhvillimin e sektorit të energjisë dhe përmirësimin e rrjetit të transmetimit, tjetra për Projektin e Ngrrotores Solare të Prishtinës.

PRISHTINË, 22 MARS - Në fjalimin mbajtur në dyvjetorin e marrjes së detyrës si kryeministër, Albin Kurti të mërkurën ka numëruar ato që i ka cilësuar si pengesa në punën e qeverisë që ai udhëheq dhe sukseset që ka thënë se janë arritur. Në mesin e pengesave ai ka numëruar pandeminë, telashet me furnizim me vaksina, krizën energjetike dhe krizën ekonomike pas nisjes së luftës në Ukrainë. Pavarësisht prej këtyre, ai ka thënë se ka pasur suksese të qeverisjes duke përmendur vaksinimin e shpejtë dhe rritjen ekonomike. Shefi i ekzekutivit ka përmendur

këtu edhe subvencionimin e faturave të rrymës e “disa masa të punësimit”. “Nesër në këtë kohë bëhen dy vjet nga dita e parë e shërbimit tonë. Shpresa për më mirë dhe besimi që ajo mund të arrihet janë edhe shkaku edhe arsyeja se pse ne jemi këtu. Të zgjedhurit e popullit, për të bërë ndryshimin me një kabinet të përzgjedhur për ta realizuar potencialin. Sot pandemia Covid-19 për shumë prej nesh edhe mund të na duket si një kujtim i largët, por është dhembja për humbjen e familjarëve e miqve që na kujton rrezikun që kemi jetuar vetëm dy vjet më parë. Dy vjet

më parë, në mars të vitit 2021, për fat të keq të qytetarëve tanë, Kosova nuk kishte asnjë kontratë për vaksina. E tillë ishte e vetmja në rajon pasi qeveria paraprake kishte dështuar t’i sigurojë ato. Virusi korona ishte shkaktuar i krizës globale. Mbyllja për ta menaxhuar shkallën e shpërndarjes kishte ulur aktivitetin ekonomik”, ka theksuar Kurti. Kryeministri Kurti theksoi se ekonomia botërore praktikisht pauzoi dhe qytetarët të mbyllur e kishin të pasigurt të ardhmen e tyre. “Në fund të vitit 202 kontinenti i Evropës po ballafaqohej me energji

elektrike, më pak energji në treg nënkuptonte rritje të çmimit. Fillimi i vitit 2022 përshkoi Evropën, por jo befasisht. Agresioni publik dhe diplomatik ndaj Ukrainës më 24 shkurt mori atë ushtarak-traditional. Energjia elektrike që mundëson prodhimin dhe nafta që mundëson transportin e produkteve të prodhuara njëra në fillim e tjetra në fund të zhvillimit, ndikuan drejtpërdrejt në inflacion. Në mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme të gjenerimit të energjisë-elektrike dhe ndaj produkteve, zhveshi paturpësisht këtë qeverisje. Vendi kishte nevojë për rikthim,

rikuperim dhe ringjallje. Qeverisë sonë iu deshën vetëm dy muaj. Ndërruam dhe negociuam kontratën me ‘Pfizer’ për vaksina. Siguroam 2 milionë sosh, bashkë me ndihmën dhe donacionet e partnerëve tanë. Përkundër prej vështirësive nga pandemia, pas luftës në Ukrainë, rritja mesatare ekonomike për këto dy vjet ka qenë prej 7-përqindësh, që ishte më e lartë se çdo rritje tjetër mesatare për dy vjet tjera rresht që nga shpallja e pavarësisë. Buxhetit iu shtuan 760 milionë euro për dy vjet e ekonomisë 2.3 milionë euro”, ka thënë Kurti.

## Liburn Aliu fton kompanitë të japin propozime për rrugën Prishtinë - Mitrovicë

PRISHTINË, 22 MARS - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka njoftuar se përfundimi i rrugës Prishtinë - Mitrovicë do të zgjasë 25 muaj. “Sot është publikuar njoftimi specifik për Prokurim për Shërbimet Konsulente për Rishikim të Dizajnit dhe Mbikëqyrjen e

Punëve Ndërtimore në Rrugën N2 Prishtinë - Mitrovicë me gjatësi 9.78 km. Shërbimet do të mbulojnë një periudhë prej njëzet e pesë (25) muajsh kalendariq nga data e fillimit, ku përfshihen: tre muaj shqyrtimi i dizajnit, përgatitja e dosjes së tenderit, procedurat e prokurimit dhe

vlerësimi i ofertave, 20 muaj periudha e mbikëqyrjes së punimeve dhe dy muaj periudha e finalizimit të projektit. Ftohen të gjitha kompanitë konsulente ndërkombëtare dhe vendore të interesuara që t’i dorëzojnë propozimet e tyre”, ka shkruar Aliu në “Facebook”.





# Për njeriun e mirë, të munguar

Nga: Ben ANDONI

Në ditët tona flitet shumë për njeriun e mirë! Flitet po kaq për traditat familjare të aksh njeriu, nga vetë ai, njeriu! Në ditët tona, kushdo mëton sesi duhet të jetë njeriu, pa qenë njeri! Por, njeriu i mirë dhe i vërtetë duket se na mungon. Sepse, ai, njeriu i vërtetë, nuk thotë asnjëherë se unë jam...

Pa dashur të futemi në karakterin filozofiko-sociologjik të këtij termi, po saktësojmë: ky shkrim i dedikohet profesor Selim Islamit në 100-vjetorin e lindjes së tij. I ndjeri Moikom Zeqo, në stilin e vet eliptik, do t'i kushtonte një shkrim postmortum me keqardhjen e thellë, i cili nënkuptonte se njerëz të tillë nuk do të na vinë ose një shoqërie i duhet shkallë emancipimi dhe periudha të tëra historiko-sociale të na sjellin të tillët. Pse atëherë dhe jo sot? Pse Shqipëria e dikurshme kishte personazhe që i blatoheshin shumë cilësi të mira dhe mund të gjeje shumë idealizëm? Befas, shkruan diku Majakovki, të gjithë burrat e bukur u zhdukën!

Edhe pse kjo i shkon periudhës më të errët të një shoqërie, si ajo që pësoi hapësira ish-sovjetike me Revolucionin e Kuq, një gjë është e paqartë, pse nuk kemi më në shoqëri personalitete të vërteta, që t'u dedikohemi dhe t'i kemi modele. Mbase kjo të shkon ndërmend në ditën përkujtimore të profesor Selim Islamit. Dhe, duket se përgjigja është e thjeshtë. Nëse të duhet të bësh atë që bëri profesor Seim Islami, do të duhet të ngjitesh e të zbresësh pareshtur në vende të ndryshme arkeologjike, të luftosh me armë në dorë (ish-partizani), të studiosh pareshtur pa bërë gjasma, e pa pasur nevojën se do të bësh bujë dhe mbi të gjitha të vendosësh kritere morale.

Profesor Eqrem Çabej mbështeti me anë të gjuhës tezën e filiacionit të shqiptarëve nga ilirët në rrafshin gjuhësor, por ishte profesor Selim Islami, i cili mban peshën e drejtimit dhe strukturimit të historisë shkencore të qytetërimit, shtetit dhe të qytetit Ilir. I tillë ishte sarandjote Islami, lindur në Pandalejmon, plot një shekull më parë, kujtim që nuk e ndau kurrë bashkë me adhurimin për originën çame.

Në një nga kujtimet thuhet se kur ndërtohej shkolla e fshatit vetofroi gurët e shtëpisë së tij të lindjes për të ndërtuar shkollën e re. Nga e vjetra, dikur, ku mori mësimet e para dhe u shpërngul drejt Normales së Elbasanit (universitetin moral të shqiptarëve kur s'kishim një të tillë) e pastaj Moskë. Diplomohet si etnolog dhe i kushtohet në punën e tij jetës dhe ekzistencës së shqiptarëve të Ukrainës, ku ende kemi disa foto të tij, që presin të ekspozohen për publikun. Kushedi me sa dhimbje do ta përcillte sot



tragjedinë e tyre, tashmë që janë mu në pjesën më aktive të luftës nën renë e armatimit të llahtarshëm rus.

Prof. Selim Islami me kalimin e viteve së bashku me kolegët e tij: prof. Hasan Ceka, prof. Skënder Anamali, prof. Frano Prendi dhe pak të tjerë do të japin dhe krijojnë elitën e studiuesve shqiptarë të arkeologjisë dhe modelin për t'u ndjekur. Puna studimore e tij por edhe e kolegëve të sipërpërmendur ndahet me vështirësi nga puna e madhe në terren. E nisi këtë punë, diktuar nga krijimi i liqenit artificial të Matit për të bërë gjermimet e plota në tumat e Matit.

Në një nga kujtimet thuhet se kur ndërtohej shkolla e fshatit vetofroi gurët e shtëpisë së tij të lindjes për të ndërtuar shkollën e re. Nga e vjetra, dikur, ku mori mësimet e para dhe u shpërngul drejt Normales së Elbasanit (universitetin moral të shqiptarëve kur s'kishim një të tillë) e pastaj Moskë. Diplomohet si etnolog dhe i kushtohet në punën e tij jetës dhe ekzistencës së shqiptarëve të Ukrainës, ku ende kemi disa foto të tij, që presin të ekspozohen për publikun. Kushedi me sa dhimbje do ta përcillte sot

tragjedinë e tyre, tashmë që janë mu në pjesën më aktive të luftës nën renë e armatimit të llahtarshëm rus. Prof. Selim Islami me kalimin e viteve së bashku me kolegët e tij: prof. Hasan Ceka, prof. Skënder Anamali, prof. Frano Prendi dhe pak të tjerë do të japin dhe krijojnë elitën e studiuesve shqiptarë të arkeologjisë dhe modelin për t'u ndjekur. Puna studimore e tij por edhe e kolegëve të sipërpërmendur

ndahet me vështirësi nga puna e madhe në terren. E nisi këtë punë, diktuar nga krijimi i liqenit artificial të Matit për të bërë gjermimet e plota në tumat e Matit.

Ky libër përmban jo thjesht emrat e atyre personaliteteve dijetarë të Lashtësisë që shkruan për Ilirinë, por edhe dëshmitë e tyre, një nga librat më të plotë kushtuar ilirëve në gjuhën tonë. Libri është i madh sa përmasat e Biblës dhe në të vërtetë ky libër është Bibla e ilirologjisë për ne shqiptarët, shprehje gati në apoteozë Moikom Zeqo. Madje, diku shton edhe një nga amanetet e tij, kur i kujtohet të botohet edhe me krestomacinë. "Eh, kjo është ëndrra ime më e madhe e jetës, tha Selim Islami.

Në bibliotekën time në shtëpi kam përgatitur 30 vëllime të autorëve më të rëndësishëm të motshmërisë, ku njëra faqe është në gjuhën origjinale, fjala vjen të Herodotit, të Tit Livit, të Salustit, të Euseb Hieronimit, të Prokopit të Cezaresë etj., dhe në faqen tjetër është përkthimi im i saktë dhe në mënyrë akribike në shqip" (Ibid).

Siç e thamë pak më sipër, ai nuk e ndau kurrë studimin me punën në terren, por ndërkohë ia vlen të përmendet puna që bëri në vitet 1958-60, që do mbahet si moment kthese për arkeologjinë tonë, pasi nën drejtimin e profesorit rus, V. Blavaeki, u punua në qytetin e famshëm të Apolonisë, kur punoi në formë të plotë ekspedita shqiptaro-sovjetike. Ajo konsiderohet si një nga ndërmarrjet më të mëdha në terren, ku morën pjesë të gjithë arkeologët shqiptarë, një grup prej 20 studentësh e mbi 200 punëtorë gjermimi.

Gjermimet vazhduan edhe në qytetin e Orikut (Vlorë) e në Çukë të Ajtoit, që konsiderohet një shkallë më e lartë e studimeve dhe, ku sipas studiuesve, u hodhën bazat e metodës shkencore të gjermimeve arkeologjike shqiptare. Këto janë vitet kur del roli i tij si organizator i mirë dhe drejtues i qartë shkencor. Pak kohë më vonë (1962), prof. Islami sërish me një nga njerëzit që i dha aq shumë arkeologjisë shqiptare, mbase dekani i saj, profesor Hasan Cekën parashtror në Konferencën e parë albanologjike, arritjet kryesore arkeologjike në fushën e kulturës ilire, që hedh dritë për autoktoninë.

Ai do kthehej sërish në terren ku gjërmoi në Kalanë e Xibrut (Mat), në Zgërdhesh (Krujë), në Çukë të Ajtoit e në qytetin antik të Butrintit. Meritë e këtyre punëve është se falë gjetjeve, nisi studimet e strukturuar për qytete ilire dhe zhvillimin e jetës aty si edhe fazat e ndryshme të zhvillimit, ku siç thuhet nga profesor Korkuti: ajo që është interesante dhe i nderon profesorët Islami, Ceka, Anamali dhe Prendin është se "ushtruan veprimtarinë e tyre në 50 vitet e shekullit të kaluar, në kushtet e një izolimi të plotë. Ata punuan me shpëtim të madh për të vërtetën historike. Me përgjegjësinë e specialistit dhe me objektivitet shkencor, u angazhuan në zgjidhjen e problemeve më të mëdha të arkeologjike e të historisë antike të vendit tonë dhe sot kur tentojmë të gjykojmë mbi veprimtarinë e tyre shkencore, vërejmë se ka shumë pak për të rishikuar e korigjuar. Prandaj puna e prof. Selim Islamit dhe e kolegëve të brezit të tij do të qëndrojë në themel të të gjitha

kërkimeve e studimeve të ardhshme të arkeologjisë shqiptare", referohet në nekrologjinë që Korkuti shkroi për të.

Ish-luftëtari i Luftës së Dytë, Selim Islami, i mbronte jo thjesht me argumente e logjikë idetë dhe gjetjet arkeologjike, por kishte kurajën edhe të debatonte qoftë me instancat. Në një rast të tillë, thuhet se ka kërkuar që të debatohej me Kryeministrin e kohës, Mehmet Shehu, që kishte kërkuar të ndërtohen disa qendra zjarri në Jug në një nga vendet arkeologjike. Të tilla grimca janë të pamjafta për të plotësuar figurën e tij, por krijuesi i teorisë së shtetit dhe të qytetit ilir, që respektoi të gjitha studimet dhe disiplinat peizazhin shkencor ilir tregoi shumë më tepër me modelin e tij. Dhe, kësaj i shtohet edhe fakti që Selim Islami ka qenë një studiues, pedagog dhe orator i denjë, që ka mbetur në memorien e brezave të tërë të studentëve.

Mbase është e tepërt, por tregohet se në fund të jetës u la amanet njerëzve të tij, ta varrosnin në Çukë e Ajtoit, pika më ekstreme e kufirit Shqipëri - Greqi. Bash, një seksion i saj është në atriumin e Muzeut Historik Kombëtar, ku vetëm pak metra më tutje, i biri i tij, Agron Islami po restauron mozaikun e madh. Të këtë koha një lloj kodi, që afron detaje të jetës në këtë lloj forme, ku puna dhe dedikimi nuk e braktisin familjen, Islami. Mbase, por kujtimi i prof. Islamit, duket se është tashmë në stendat, librat dhe memorien e gjallë të njerëzve, që i kanë lënë Shqipërisë aq shumë, mbi të gjitha modelin e njeriut të mirë shqiptar, aq të rrallë, e aq të vetëm. Si ai. (Homo Albanicus).

# Pesë ditët e Kongresit të Lushnjës (1920) dhe vendimet e tij



## Nga: Kastriot DERVISHI

Kongresi i Lushnjës është ngjarja më kryesore pas Kuvendit të Vlorës së vitit 1912, dhe Kongresit të Durrësit të vitit 1918. Ai u mbajt në kushtet kur Shqipëria rrezikohej nga copëtimi në kushtet e mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Austro-Hungaria nuk ekzistonte më, ndërsa Italia ndaj Shqipërisë kishte synime të pangjashme me ato që viteve 1912-1914. Kongresi u organizua nën nxitjen britanike, nga konsulli Eden dhe përçonte këtë politikë. Karakteri i parë i Kongresit ishte ai anti-italian. U bashkuan në këtë linjë fituesi i vetëm i Luftës së Parë Botërore, Esat Toptani (zgjedhi delegatët e Tiranës) dhe gjithë klasa humbëse e kësaj lufte që kishte qenë me Austro-Hungarinë (organizatorët kryesorë të kongresit), duke pranuar të qeverisnin Shqipërinë e 1913-s.

### 21 janar 1920

Në orën 10:00 u çel mbledhje në shtëpinë e Kase Fugës. Pjesëmarrja nuk ishte e plotë. Mbledhja filloi me një lutje të Sheh Ibrahim Karbunarës e të Ferit Vokopolës. Për komisionin organizator, Aqif Biçakçiu (Elbasani) mbajti një ligjëratë në përgjigje të fjalës së mikpritësve. Një komision i përbërë nga Ibrahim Ohri, Qazim Kokoshi, Kostaq Kotta, Fasli Frashëri dhe Adem Gjinishi kontrollon letër-përfaqësimet. Meqenëse nuk kishin ardhur të gjithë delegatët, mbledhja u mbyll dhe i rinisi punimet më 28 janar.

### 28 janar 1920

Në orën 14:00 rinisën punimet. U verifikuan mandatet. Xhavit Leskoviku mbajti fjalën e hapjes, në emër të grupit nismëtar, duke përmendur shkaqet që çuan në mbajtjen e mbledhjes kombëtare. U zgjedh kryesia e kongresit:

Aqif Biçakçiu (Elbasani) – kryetar.  
Sotir Peci – nënkryetar.  
Kostaq Kotta – sekretar.  
Ferit Vokopola – sekretar.

U mbajt zi për Abdyl Ypin e vrarë ato ditë dhe mbledhja e mbyll.

### 29 janar 1920

Në orën 9:00 u çel mbledhja. Nënkyetari i kongresit Sotir Peci parashtrori rendin e ditës së mbledhjes:

1. Masat që duhet marrë kundër vendimit të tri fuqive të Antantës për copëtimin e Shqipërisë sipas paktit të Londrës 1915.
2. Zgjedhjen e qeverisë së re sipas programit që do caktonte kongresi.
3. Formën e regjimit që do kishte përkohësisht shteti shqiptar.
4. Votëbesimi i qeveria e përkohshme.
5. Zgjedhjet e autoriteteve sipas vendimit që do të jepet.

Për të kundërshtuar Paktin e fshehtë të Londrës të vitit 1915, u vendos të bëhen protesta të shumta si dhe u ngrit një komision i përbërë prej 10 anëtarësh. Në lidhje me Qeverinë e Durrësit, kongresi vërejtë se:

a – Ka vepruar jashtë tagrit dhe

programit të dhënë nga kongresi i Durrësit.

b – Ka sjellë pengesa që kanë çuar në mosmbledhjen e Senatit.

c – Administrata e keqe ka shkakuar anarki në të gjithë anët e Shqipërisë.

ç – Duke mbështetur politika të veçanta, ka sjellë një gjendje të keqe politike në Shqipëri.

e – Duke përdorur intrigat ka penguar Mbledhjen e Lushnjës.

Nisur nga këto, Kongresi me 45 vota pro dhe gjashtë kundër vendosi rrëzimin e qeverisë si dhe zgjedhi delegacionin shqiptar në Konferencën e Paqes të përbërë nga Luigj Bumçi, Mehmet Konica dhe Mihal Turtulli.

### 30 janar 1920

Në orën 9:00 u çel mbledhja. U bisedua në lidhje me protestën që do t'i dërgohej Konferencës së Paqes si dhe letrën që do t'i dërgohej Senatit amerikan. Nuk u ra dakord për letrën që do t'i dërgohej Parlamentit italian, sepse ishte e butë. U vendos të formohej një komision. Për formën e regjimit, nuk u kundërshtua monarkia, por u vendos krijimi i Këshillit Kombëtar (Senati) në rolin e organit legjislativ të shtetit dhe Këshilli i Naltë (KN) në rolin e përkohshëm të kryetarit të shtetit. Bazat e Kanunores së KN-së me gjashtë pika, përbënë njëjën e parë kushtetuese funksionale të Shqipërisë. KN-ja përveç rastit të parë në Lushnjë, zgjidhej nga legjislativi. KN-ja mund të zgjidhte një kryeministër në kohë krize. Funksioni i saj përfundonte me

ardhjen e mbretit. Pas miratimit të kësaj "dispozite kushtetuese".

Iljaz Vroni propozoi 4 anëtarët e Këshillit të Naltë:

1. Aqif Biçakçiu.
2. Abdi Toptani.
3. Mihal Turtulli.
4. Imzot Luigj Bumçi.

U votuan njëzëri. Këta dy të fundit u vendos që të mbeteshin në Konferencën e Paqes në Paris, ndërsa punën ta vijonin dy këshilltarët e tjerë. Delegati Bektash Cakrani propozoi ministrat e kabinetit të ri:

### Sulejman Delvina (kryeministër),

Iljaz Vroni, Ahmet Zogu, Sotir Peci, Ndoc Çoba, Mehmet Konica, të cilët u miratuan njëzëri me përjashtim të Iljaz Vronit, i cili me dëshirën e vet ia la vendin Hoxhë Kadriut. Delegati Idhomen Kosturi propozoi që qeveria të betohej para mbretit (Këshillit të Naltë). Nënkyetari S. Peci tha se duhej së pari që KN-ja të betohej para kongresit, e qeveria para KN-së. Aqif Biçakçiu kërkoi që edhe delegatët të betohen para KN-së. Pas këtyre filloi zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Kombëtar (Senati), organit legjislativ të shtetit.

U caktua një komision me tetë anëtarë.

### 31 janar 1920

Në orën 9:00 u çel mbledhja. Delegati Eshref Frashëri tha se sipas disa lajmeve, vendi ka ngelur

pa qeveri e për këtë duhej që sa më parë të shkonin në Durrës. Iljaz Vroni tha se shumica e ministrave nuk ndodheshin në Lushnje atë çast. Për të mos u gjendur para ndonjë krize ministrove, u vendos ndarja e portofoleve e plotësimi i qeverisë si vijon:

Sulejman Delvina – kryeministër.  
Ahmet Zogu – ministër i Punëve të Brendshme.

Sotir Peci – ministër i Arsimit.  
Hoxha Kadri – ministër i Drejtësisë.  
Hysen Vroni – zëvendëskryeministri dhe për Postë-Telegrafët, Idhomene Kosturi.

Ndoc Çoba – ministër i Financave.  
Idhomen Kosturi – zëvendësisht ministër

Po ashtu, mbledhja zgjedhi vetëm për këtë herë dhe dy drejtorë të përgjithshëm: për Punët Botore Eshref Frashëri (i cili do ishte një lloj zëvendëskryeministri) dhe për Postë-Telegrafët, Idhomene Kosturi.

Kongresi i rihapi punimet ora 15:00. U vendos caktimi i numrit 37 të deputetëve, si dhe miratoi listën e paraqitur. Në mbyllje, Xhafer Ypi falënderoi Lushnjën dhe propozoi të asaj t'i jepej një vend i veçantë deputeti në Këshillin Kombëtar. Sheh Karbunara mori fjalën e tha se Lushnja bëri veçse detyrën. Atëherë Eshref Frashëri, propozoi që t'i shkruhej një letër falënderimi popullit të Lushnjës.

Delegatët e Shkodrës, Lezhës e Malësisë së Gjakovës, nuk morën pjesë në Lushnje dhe i nënshkruan vendimet në Tiranë më 13 shkurt 1920.

# Si po e ri-formaton Evropën Giorgia Meloni



Nga: **Nicholas FARRELL**  
"The Spectator"

Kryeministrja e parë grua e Italisë, Giorgia Meloni, po bëhet vazhdimisht udhëheqësja politike më e rëndësishme e Evropës. Madje disa thonë se është fati i saj të jetë Angela Merkel e radhës. Nëse do të ndodhë vërtet, kjo do të nënkuptonte një ndryshim dramatik në drejtimin e Bashkimit Evropian drejt asaj që ajo e quan një Evropë konfederale, në vend të një Evrope federale.

Pra një Evropë e komebeve sovraane dhe jo një super-shtet, gjë që sipas Melonit do të "bënte më pak, por më mirë". Meloni, 46 vjeçe, drejton një koalicion qeveritar të krahut të djathtë – që përbëhet nga partia e saj Fratelli D'Italia (Vëllezërit e Italisë) plus 2 partnerë të vegjël, Lega e Matteo Salvinit dhe Forza Italia e Silvio Berlusconi – që fitoi një shumicë të gjerë në zgjedhjet parlamentare të shtatorit 2022.

Në këtë mënyrë, ajo u bë kryeministrja e parë e zgjedhur me votë në Itali që nga viti 2011. Asnjë nga 6 kryeministrat e mëparshëm nuk ishte udhëheqës i një partie apo koalicioni që fitoi zgjedhjet kur u emërua në detyrë. Madje 4 prej tyre nuk ishin as deputetë.

Ndërkohë partitë e krahut të majtë të opozitës, nuk janë në gjendje të sheshojnë dallimet midis tyre për të formuar një koalicion alternativ efektiv. Partia Demokratike post-komuniste, e cila doli e dyta në zgjedhje me 19 për qind të votave, po merr aktualisht vetëm 16 për qind në sondazhe, ndërsa po vazhdon të rritet popullariteti i Fratelli D'Italia.

Ajo mori 26 për qind të votave në zgjedhje, dhe tani në sondazhe renditet me 31 për qind mbështetje. Largimi i Merkel në vitin 2021 në fund të mandatit të saj të katërt si

kancelare e Gjermanisë, krijoi një boshllëk në Evropë, i cili nuk është mbushur ende.

Shpresat e presidentit francez Emmanuel Macron për ta zëvendësuar atë si udhëheqëse de facto të BE-së u zhdukën që shumë kohë më parë (pavarësisht se kushtet për një lidhshmëri nuk kanë qenë kurrë më të mira sesa këto vitet e fundit), në një kohë që kancelari aktual gjerman Olaf Scholz njihet më së shumti për ngurrimin e tij tipik.

Nga ana tjetër Meloni po e forcon gjithnjë e më shumë staturën e saj kombëtare dhe ndërkombëtare. Shkalla e popullaritetit të saj prej 52 për qind është shumë më e lartë se ajo e Scholz (34 për qind) dhe e Macron (vetëm 28 për qind).

Kryeministrja italiane – që identifikohet si një konservatore, por jashtë Italisë është quajtur pa dyshim si një ekstremiste i djathtë – që ka plane shumë ambicioze për Italinë dhe Evropën. Shumë kohë përpara pushtimit rus të Ukrainës, ajo hoqi dorë nga pozicioni tradicionalisht anti-amerikan i së djathtës italiane për ta vendosur Italinë në një pozicion të ngjashëm me atë të Britanisë së Madhe.

Por edhe pse atlantizmi i saj është një nga shkaqet e mundshme të tensionit brenda BE-së, ajo është e vendosur të mos i trazojë shumë ujërat për dy arsye kryesore. Së pari, Italia do të marrë më shumë se çdo shtet tjetër anëtar para nga Fondi i Rimëkëmbjes i BE-së për krizën e shkaktuar nga Covid-19.

200 miliardë euro (një e katërta e totalit) midis viteve 2021-2026 në formën e kredive dhe granteve, por vetëm me kushtin që të ndërmarrë dhjetëra reforma strukturore. Për këtë arsye nuk ka luksin të përplasit Komisionin Evropian.

Së dyti, ajo nuk ka ende aleatë për ta fituar një luftë kundër Brukselit. Për këtë arsye, Meloni është e detyruar

të ndërtojë një rrjet aleancash dhe të fitojë një rol kontrollues në Parlamentin Evropian, që ka një rol të madh mbi emërimet kyçe në Komisionin Evropian. Pikërisht këtu qëndron fuqia e vërtetë në BE. Në zgjedhjet e fundit të Parlamentit Evropian të vitit 2019, Fratelli D'Italia mori vetëm 6.4 për qind të votave dhe 5 eurodeputetë (një numër që u rrit në 8 për shkak të Brexit-it dhe largimeve). Por ajo është drejtuese e grupit parlamentar të cilit i përkasin konservatorët evropianë euroskeptikë dhe reformistët (ECR), që u bashkë-themelua nga David Cameron në vitin 2009.

Aktualisht, ECR ka vetëm 64 eurodeputetë. Tradicionalisht, grupi i Partisë Popullore Evropiane (EPP), që ka në përbërje partitë demokristiane, dhe që ka aktualisht 176 eurodeputetë, e ka kontrolluar PE, që pas Brexit ka 705 vende në total.

Ajo hyn zakonisht në aleancë me kundërshtarët e saj natyralë, socialistët (S&D), me 144 eurodeputetë, edhe herë pas here me Renew (ish liberalët), që ka 102 eurodeputetë (përfshirë eurodeputetët e Macron plus ata të Guy Verhofstadt). Megjithatë, në legjislaturat e fundit, pjesa e vendeve të EPP-së ka rënë ndjeshëm, ndaj është rritur nevoja për aleatë.

Meloni synon të zëvendësojë rolin e S&D, të zhytur keqazi në skandalin e miliona eurove të dhëna në formën e rryshfeteve, Qatargate, ku ECR do të jetë aleatja kryesore e EPP-së në zgjedhjet evropiane të vitin e ardhshëm, kur Fratelli D'Italia parashikohet të rrisë ndjeshëm përfaqësimin e saj në PE.

Po ashtu, anëtarët e tjerë të ECR, veçanërisht partia populiste spanjolle Vox, mund të jetë partnerja e vogël në atë që sondazhet parashikojnë se do të jetë

një qeveri e koalicionit të krahut të djathtë në zgjedhjet spanjolle këtë vit. Ndërkohë në këtë grupim janë edhe Demokratët Suedezë, të cilët dolën shumë mirë në zgjedhjet e shtatorit 2022, dhe mbështetja e të cilëve është jetike për qeverinë e re të krahut të djathtë.

As Tubimi Kombëtar i Marine Le Pen, Lega i Salvinit apo Alternativa për Gjermanisë (AfD) nuk janë pjesë e ECR, por e grupit rival Identiteti dhe Demokracia (ID), që ka gjithashtu 64 eurodeputetë. Lega, që ka pësuar një rënie të vazhdueshme dhe që arriti kulmin i saj në zgjedhjet e fundit evropiane të 2019-ës, nuk do të jetë në gjendje të përsërisë 34 për qindëshin e saj spektakolar.

Ndërsa shumë në EPP e konsiderojnë ID-në si një grupim më rënie të pandalshme, ata janë shumë më të hapur për një aleancë me ECR-në. Edhe Meloni do të përpiqet ta bindë partinë e Salvinit të braktisë ID-së. Manfred Weber – udhëheqësi i EPP-së nga Unioni Kristian Social, versioni bavarez i Unionit Demokristian të Merkelit – është takuar dy herë me Melonin në Romë që kur ajo u zgjodh kryeministre.

Evropa konfederale që dëshiron Meloni është ajo në të cilën dominon parimi i subsidiaritetit. Siç tha ajo në një intervistë për gazetarin e njohur italian Bruno Vespa: "Brukseli nuk duhet të bëjë atë që Roma mund ta bëjë më mirë". Kur u pyet nëse ligji i BE-së duhet të mbizotërojë ndaj ligjit italian në rastet e konfliktit, ajo u përgjigj: "Për rastet më të diskutueshme Gjykata Kushtetuese gjermane ka vendosur në favor të interesit kombëtar".

Vizita e Melonit pak kohë më parë në Kiev, menjëherë pas asaj të presidentit amerikan Joe Biden, për të takuar Volodymyr Zelensky dhe për ta siguruar atë se Italia do ta

mbështesë me armë "deri në fund" ishte shumë domethënëse. Sepse ndërsa Macron ndryshoi qëndrim në lidhje me mënyrën se si Evropa duhet të reagojë ndaj pushtimit të Vladimir Putinit, dhe Scholz u tërhoq nga sjellja nguruese, mbështetja e Melonit si për sanksionet ndaj Rusisë po ashtu edhe për armët ndaj Ukrainës ka qenë e paqartë që nga fillimi i luftës, kur ajo ishte ende në opozitë.

Shumë analistë thanë se vendimi i Macron për të ftuar vetëm Scholz-in dhe jo Melonin në takimin me Zelensky në Paris dy javë më parë, ishte një shenjë e qartë se udhëheqësja e ekonomisë së tretë më të madhe të BE-së ishte mënjanuar nga "salla e komandimit" të BE-së.

Po ashtu ata nënvizuan se Meloni ishte dobësuar nga deklarata e Silvio Berlusconi, një mik i vjetër i Putinit, se nëse do të ishte kryeministër, nuk do të shkonte kurrë që të takonte Zelenskin, sepse "sulmet e tij në Donbas kishin shkaktuar shkatërrimin në Ukrainë".

Meloni zgjodhi ta shpërfillë komentin e Berlusconi. Por kryeministrja italiane është e ashpër jo vetëm me dy partnerët e saj të koalicionit, por edhe me shumicën e vendit të saj që kundërshton dërgimin e armëve në Ukrainë (vetëm pak më shumë se 1/3 e italianëve e konsiderojnë Rusinë si armike, krahasuar me 2/3 në Amerikë dhe Britani, madje çereku i italianëve e konsiderojnë Rusinë si aleatë).

"Meloni është tani udhëheqësja e së djathtës evropiane. Ajo dhe ata që janë rreth saj do të jenë në gjendje të lëvizin boshnin e politikës evropiane në zgjedhjet e ardhshme"- thotë Massimo Cacciari, profesor filozofie, ish-deputet komunist dhe ish-kryetar i bashkisë së Venecias.

Marrë me shkurtime

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Berisha e Rrudhani: Synojmë rezultat pozitiv në Izrael

“Dardanët”, me një atmosferë të mirë sportive, e kanë kompletuar edhe stërvitjen e tretë para ndeshjes me Izraelin që zhvillohet të shtunën në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian. Futbollistët Valon Berisha dhe Donat Rudhani kanë shprehur optimizëm se Kosova mund të marrë një rezultat pozitiv

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të mërkurën e ka zhvilluar edhe seancën e tretë stërvitore në kuadër të përgatitjeve për ndeshjet e para kualifikuese për “Euro 2024”. Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se para fillimit të stërvitjes përzgjedhësi i “dardanëve”, Alain Giresse, e ka mbajtur një videoanalizë të shkurtër me futbollistët, derisa gjatë stërvitjes është punuar me intensitet të plotë.

Mesfushori i spikatur Valon Berisha ka folur pas stërvitjes, duke thënë se atmosfera është shumë e mirë dhe stërvitja ishte shumë intensive. Berisha, i cili ka udhëtuar dy ditë për të qenë pjesë e Kosovës në ndeshjet e marsit, ka vlerësuar se Kosova dhe Izraeli janë në të njëjtin nivel dhe se “dardanët” duhet të marrin të paktën një pikë nga kjo ndeshje. “Ekipi po punon mirë dhe kemi filluar ta përgatitim lojën tonë, të cilën do ta aplikojmë kundër Izraelit. Sigurisht se do të jetë një ndeshje e vështirë sepse ata luajnë para

tifozeve të vet. Edhe moti është më ndryshe sesa me atë që jemi mësuar ne. Temperatura do të jetë një sfidë e vështirë. Edhe ata duan të arrijnë në topdyshe e grupit dhe mendoj se jemi në të njëjtin nivel”, ka thënë Berisha dhe ka shtuar: “Është një ndeshje shumë e rëndësishme në të cilën duhet të marrim një pikë jashtë, së paku. Normalisht, fitorja është ajo që duam, por me rëndësi është të mos humbim. Misioni i kualifikimit a është i mundur? Besoj se po. Ajo që është kryesore për ne është se shumë lojtarë kyçë në kombëtare janë duke



luajtur rregullisht në ekipet e tyre dhe janë në formë të mirë. Ky ndoshta ka qenë edhe fakti që është kërkuar më së shumti të përfaqësuesja jonë, që me sjell formën e tyre të mirë dhe të jenë të gatshëm për ta dhënë

maksimumin për Kosovën”. Pas stërvitjes foli edhe futbollisti Donat Rudhani. Ky i fundit ka konfirmuar se objektivi i Kosovës është kualifikimi në Kampionatin Evropian. “Jemi duke punuar me përkushtim dhe shpresoj se gjithçka do të shkojë mirë. Objektivi i kualifikimit në Evropian? Po, kjo është e qartë. Të gjithë kemi besim dhe dëshirë për ta arritur këtë gjë. Besoj se do të kualifikohemi, por kjo gjë arrihet vetëm me punë dhe për këtë arsye jemi duke punuar çdo ditë. Të gjithë jemi në top-formë dhe besoj se do t’ia dalim të gjithë së bashku”, ka thënë Rudhani. Lidhur me ndeshjen ndaj Izraelit, Rudhani ka deklaruar: “Është një kundërshtar relativisht i fortë, por besoj se do të kthehemi me rezultat pozitiv”.

## Alarmojnë klubet: MKRS-ja ta licencojë FFK-në, po futemi në krizë financiare

Prishtinë, 22 mars - Edhe më tutje Federata e Futbollit e Kosovës vazhdon të jetë një nga federatat e pakta që ka mbetur pa u licencuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Shpresat që ky proces të përfundojë në ditët në vijim janë më të mëdha pas lirimit nga akuzat e kryetarit të kësaj federate Agim Ademi, që ishte një nga kushtet e MKRS-së që kjo federatë të licencohet. Nga ky moslicencim i FFK-së po e pësojnë klubet e futbollit të cilat kanë bërë thirrje drejtuar MKRS-së që të merret seriozisht me këtë proces pasi janë duke u futur në një krizë të thellë financiare. Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, ka thënë për “KosovaPress” se dëmi që po e pësojnë klubet është shumë i madh dhe nëse vazhdohet kështu, futbollit i Kosovës do të pësojë rënie të madhe. “Mendoj se asnjë arsye më nuk është që të moslicencohet federata duke parë që me sa kemi njohuri i gjithë procesi i cili ka ngec ka qenë për shkak të atij dënimi mbi të cilin pretendohet se kryetari (i FFK-së, Agim Ademi), që ka pasur një aktakuzë, ka dalë i pafajshëm

dhe në momentin që ka dalë i pafajshëm, mendoj se federata duhet të licencohet. Dëmi është shumë i madh te klubet, te skuadrat. Mendoj se futbollit i Kosovës sapo filloi pak të këndellet, në një farë forme në momentin që nuk licencohet federata, edhe futbollit i Kosovës fillon të ketë rënie drastike të skuadrave sepse skuadrat nuk mund t’i mbulojnë shpenzimet krahas avancimit të kushteve financiare që janë tani te skuadrat tona në ligën tonë”, ka theksuar Batatina, i cili ka shtuar se ministria duhet t’i marrë parasysh rrethanat në të cilat punohet në Kosovë dhe të mos jetë aq shumë rigoroz në kërkesat e saj, por t’i shtyjë proceset përpara. “Mendoj se duhet të jetë një thirrje urgjente nga të gjitha klubet që kam pasur kontakte, nga të gjithë njerëzit, sepse ne jemi në kontakte, bisedojmë mes vete. Brenga më e madhe është moslicencimi. Shumë klube kanë humbur disa nga të hyrat që mund t’i kenë dhe çfarë do të ndodhë kur në momente të caktuara klubet të mos i paguajnë lojtarët nga tre apo katër muaj siç kemi



informacione sepse nuk ka mundësi asnjë donator ta përballojë këtë gjendje kaq të madhe financiare... Edhe kjo ministri nuk ka ardhur nga Kazakistani këtu në Kosovë, por janë njerëzit tanë, e dinë që në këtë vend mund të ketë ndoshta edhe disa gjëra që ata i kërkojnë që nuk janë ndoshta, por duhet njanjëherë t’i shtyjë proceset përpara dhe mos ta pengojmë procesin e futbollit”, ka shtuar ai. Pasojat e moslicencimit po i ndien edhe Klubi i Futbollit Gjilani. Menaxheri i kësaj skuadre, Drilon Sylejmani, duke folur për “KosovaPress”, ka bërë thirrje që të përfundojë para datës 31 mars në mënyrë që ta kenë mundësinë të përfitojnë të hyra nga sponsorët. “Moslicencimi i federatës faktikisht e ka stopuar për

momentin Ligjin e sponsorizimit dhe si te klubet e tjera në futbollin kosovar, ashtu edhe te Klubi i Gjilanit ka shkaktuar jo pak telashe, jo pak dëme, pasi jemi në pritje të marrjes së vërtetimit për disa sponsorë. Megjithatë kemi indice që procesi i licencimit do të përfundojë shumë shpejt, ndoshta kisha bërë apel që një gjë e tillë të ndodhë sa më parë në mënyrë që para datës 31 mars bizneset të cilat kanë menduar ta shfrytëzojnë Ligjin për sponsorizim t’i kompletojnë dokumentacionet e nevojshme dhe mos të kemi probleme të tjera në Administratën Tatimore të Kosovës.”, ka thënë Sylejmani. Kurse Kushtrim Sopa, administrator te Klubi i Futbollit Prishtina, ka deklaruar se nga futbollit varen rreth 4 000 familje që marrin pagë mujore dhe se ky fakt duhet të merret parasysh nga Ministria e Sportit. Sipas tij, Ligji i Sponsorizimit ndikon në stabilitetin financiar të klubeve. “Falë atij ligji të gjitha klubet kanë funksionuar mjaft mirë dhe patëm filluar t’i tejkalojmë krizat, të stabilizohemi dhe ta projektojmë të ardhmen

përpara, mirëpo pengesa që doli, që nuk u licencua Federata e Futbollit e Kosovës, ka shkaktuar probleme edhe për klubet, sidomos te Prishtina. Nuk po jap shifra të sakta, por pjesën më të madhe të buxhetit të klubit vjetor e përbëjnë sponsorët... Shpresojmë shumë që të licencohet Federata e Futbollit e Kosovës. Të gjitha informata që na vijnë në drejtim tonin janë që kanë përfunduar të gjitha procedurat dhe i bëj apel Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjegjësisht ministrit Hajrulla Çeku dhe Departamentit të Sportit, që të kenë mirëkuptim për të gjitha sportet, por në futboll janë 3 000 - 4 000 mijë familje që paguhen në baza mujore dhe është e domosdoshme për klubet sportive të procedohet tutje dhe të licencohet federata”, ka thënë Sopa. Federata e Futbollit e ka ndryshuar edhe statutin e saj në Kuvendin e Jashtëzakonshëm të mbajtur më 27 janar të këtij viti, që ishte një kusht tjetër i vendosur nga MKRS-ja për licencimin e saj.

## KOK-u: Spanja rikthen ‘regjimin’ e vjetër për sportistët e Kosovës

Prishtinë, 22 mars - Për shkak të mosnjohjes së Kosovës shtet nga Spanja, Përfaqësuesja e Karatesë nuk është lejuar të garojë e barabartë me garuesit e tjerë në Kampionatin Evropian që nisi të mërkurën në Guadalajara të Spanjës. Atyre u është kumtuar lajmi nga

organizatori se institucionet vendase nuk e kanë lejuar organizatorin t’i shfaqë simbolet shtetërore. Komiteti Olimpik i Kosovës me shqetësim të madh është duke përjetuar diskriminimet e sportistëve të Kosovës nga shtetet të cilat ende e përziejnë

sportin me politikën. Së fundi, dhe jo për herë të parë, Spanja sërish bëhet faktor, duke rikthyer “regjimin” e vjetër për sportistët e Kosovës, pavarësisht se disa vjet më parë ishte treguar korrekte në këtë drejtim dhe pikërisht me sportistët e njëjtë. “KOK-u, që është në kontakt me

FKK-në, e ka informuar menjëherë Komitetin Olimpik Ndërkombëtar (IOC), nga i cili pret reagim të shpejtë, në mënyrë që karateistët tanë të mos e humbin edhe një garë të rëndësishme, siç ndodhi javë më parë me Evropianin e të Rinjve në Qipro. Evropiani është



garë kualifikuese edhe për Lojërat Evropiane “Krakovia 2023”, thuhet në reagimin e KOK-ut.

## KB Bashkimi përjashtohet nga Liga Ballkanike

Prizren, 22 mars - KB Bashkimi është përjashtuar nga Liga Ballkanike. Kjo e fundit ka njoftuar se klubi kosovar është klubi i tretë që nuk i ka kryer obligimet ndaj Delasport Balkan League këtë sezon dhe

nuk do të marrë pjesë në pjesën e mbetur të sezonit 2022-23 në këtë ligë. "Më 15 dhe 16 mars na ka arritur një email nga KB Bashkimi, i cili informoi se 'duket e pamundur për ne të udhëtojmë dhe të zhvillojmë

ndeshje ndërkombëtare'. Prandaj, ne nuk shohim asnjë opsion për KB Bashkimi që të jetë pjesë e ligës dhe të marrë pjesë e të luajë vetëm ndeshjet që do t'i luajë në Prizren", ka njoftuar drejtori i ligës, Shay

Shtriks. Bashkimi i ka luajtur vetëm 7 nga 12 ndeshjet e këtij sezoni në Ligën Ballkanike, ndërsa së fundmi nuk ishte në gjendje t'i mbulonte shpenzimet për udhëtime dhe angazhime jashtë vendit.



## Krasniqi, Rumanisë: Kosova është vend i vogël, por ka futbollistë që luajnë në Evropë

PRISHTINË, 22 MARS - Ermal Krasniqi e ka paralajmëruar Rumaninë se nuk duhet nënvlerësuar Kosovën. Ekipet kombëtare të këtyre dy shteteve janë pjesë e Grupit I kualifikues për Kampionatin Evropian "Euro 2024". Cikli kualifikues për Evropianin fillon këtë javë, teksa Kosova dhe Rumania nuk do të përballen mes vete deri në qershor të këtij viti.

Krasniqi, i cili po shkëlqen me fanellën e gjigantit rumun, Cluj, por nuk mori ftesë nga Alain Giresse, ka dhënë së fundmi një intervistë për "ProSport.ro". 24-vjeçari paralajmëroi rumunët se nuk duhet ta shpërfillin përfaqësuesen e shtetit të tij vetëm sepse ka një popullsi 10 herë më të vogël se Rumania. "Kosova është një vend i vogël, por ka shumë talentë që performojnë çdo ditë në ligat më të forta në Evropë. Ka lojtarë të mirë në Kosovë që mund të garojnë në kampionatet evropiane", ka thënë fillimisht



ish-futbollisti i Ballkanit. "Ballkani, ish-klubi im, luajti kundër CFR [Cluj] dhe mendoj se të gjithë e vunë re se çfarë lojtarësh janë atje. Nuk është puna ime të jap rekomandime, por në Kosovë ka lojtarë të mirë që mund të garojnë në kampionatet evropiane. Mendoj se të dyja janë ekipe cilësore, por

dëshira ime është që Kosova të fitojë", ka deklaruar Krasniqi. Kosova ciklin kualifikues për "Euro 2024" e nis me ndeshjen në udhëtim kundër Izraelit, më 25 mars, kurse pas tri ditësh e pret Andorrën. Rumania më 25 mars luan në udhëtim kundër Andorrës, kurse pas tri ditësh e pret Bjellorusinë.

## Bostoni kualifikohet në 'play-off' dhe synon kreun në Lindje

SACRAMENTO, 22 MARS - Bostoni mposhti me rezultat 132-109 Sacramenton, duke qenë vetëm një fitore larg kreut të renditjes në Konferencën e Lindjes. Skuadra e Celticsit bëri një ndeshje të mirë, ku u dalluan Tatum me 36 pikë e Browni me 27 pikë. Fitoi edhe Clevelandi, që mundi me rezultat 115-109 Brooklynin jashtë fushës, ndeshje ku u dallua Mitchell me 31 pikë. Befason Oklahoma, që mundi në



sekondën e fundit me rezultat 101-100 clippersat, ndeshje ku dallimin në fushë e bëri Shai, autor i 31 pikëve. Atlanta mposhti me rezultat 129-107 Detroitin,

me Youngun protagonist, autor i 30 pikëve e 12 asistimeve. Ndërsa New Orleansi, falë 32 pikëve të Ingramit, mundi thellë San Antonion (119-84).

### REZULTATET

Orlando - Washington	122-112
Atlanta - Detroit	129-107
Brooklyn - Cleveland	109-115
New Orleans - San Antonio	119-84
Sacramento - Boston	109-132
Clippers - Oklahoma	100-101

## Ronaldo, afër një rekordi botëror

Nuk është më në skenën e rëndësishme të futbollit, por Cristiano Ronaldo ka një shans të artë për të vendosur një rekord të ri Botëror. Ronaldo është sërish pjesë e Portugalisë. Ai është

përfshirë nga trajneri Roberto Martinez në listën e lojtarëve të grumbulluar për kualifikueset e "Euro 2024", ndërsa përballë Liechtensteinit, në sfidën e tyre të parë, mund të shndërrohet

zyrtarisht në lojtarin me më shumë ndeshje në rang përfaqësuesesh. Ronaldo është në kuotën e 196 ndeshjeve me fanellën e përfaqësueses portugeze, aq sa Bader Al-

Mutawa i Kuvajtit. Nëse Ronaldo aktivizohet, që është thujtë e sigurt, portugezi do të shkojë në kuotën e 197 ndeshjeve, duke vendosur një rekord të ri. Jo vetëm ky rekord i mundshëm,

shifrat e Ronaldos të imponojnë respekt pasi në 196 ndeshje me Portugalinë ka shënuar 118 gola, ka fituar një Evropian, një Ligë Kombesh, ndërsa ka marrë pjesë në pesë Botërorë.

### SHKURT

#### Pensionohet Mesut Ozil

Pas shumë vjetësh në elitën e futbollit evropian dhe atij botëror, Mesut Ozil i ka dhënë përfundimisht fund futbollit në moshën 34-vjeçare. Ish-ylli i Kombëtares së Gjermanisë dhe skuadrave Real Madrid e Arsenal vetë e ka konfirmuar këtë lajm në rrjete sociale, duke i falënderuar të gjithë ata që e kanë mbështetur në këto 17 vjet si futbollist profesionist, përfshirë edhe klubet në të cilat ka luajtur. Ai shprehet se tashmë do të përqendrohet te familja e tij, por që nuk do t'i humbasë kontaktet me fansat. Ozili u shpall kampion bote me Gjermaninë në vitin 2014 dhe ka fituar trofe të rëndësishëm në rang klubesh si La Liga me Realin e Madridit në vitin 2013 dhe 4 Kupa FA me Arsenalin.

#### Hamiltoni për makinën e Red Bullit: Nuk kam parë kurrë një makinë kaq të shpejtë

"Të jem i singertë, nuk kam parë kurrë një makinë kaq të shpejtë. Kur ne dominonim në pistë, nuk ishim kaq të shpejtë sa ky Red Bulli i sotëm. Është makina më e shpejtë që kam parë, sidomos duke e krahasuar me makinat e tjera".

Është kjo deklarata e dhënë nga shtatë herë kampioni i botës në Formula 1, britaniku Lewis Hamilton. Dikur ai dominonte me Mercedes dhe e di se çfarë është një makinë e shpejtë. Red Bulli ka dominuar në dy garat e para të këtij sezoni, duke arritur dy fitore të dyfishta. Britaniku, në lidhje me parakalimin që Verstappen i bëri në Arabi, sqaroi: "As që u përpoqa ta mbroj vendin, pasi ishte e kotë. Ai më kaloi në një zonë me shpejtësi maksimale dhe nuk bëra asnjë manovër, pasi mes nesh ka diferenca të mëdha në shpejtësi".

#### PSG-ja në garë për Silvën

Bernardo Silva duket se është duke e kaluar sezonin e fundit në fanellën e Manchester Cityt. Repreruesi portugez verën e kaluar ishte pranë transferimit në Barcelonë, por në fund klubet nuk arritën marrëveshje. Mediumi "Relevo" raporton se interesim për mesfushorin kualitativ ka shprehur Paris Saint-Germaini. Klubi francez e ka bërë si prioritet mesfushorin qendror, i cili luan edhe si sulmues i krahut të djathtë. Interesim për Silvën ka ende Barcelona, por edhe Real Madridi. City do ta linte atë të largohej vetëm për një shumë prej 90 milionë eurove.

#### Mourinho mund të rikthehet në Real Madrid

Real Madridi mund t'i ndajë rugët me trajnerin Carlo Ancelotti. Strategu italian është afër të dështojë ta mbrojë titullin e La Ligës derisa është eliminuar nga Superkupa e Spanjës dhe është afër të eliminohet edhe nga Kupa e Mbretit. Gazetari spanjoll Oier Fano Dadebat ka bërë një raportim befasues, duke bërë të ditur se Jose Mourinho ka shanse të mëdha që të rikthehet në "Santiago Bernabeu". "Special One" dëshiron të largohet nga Roma, pasi nuk po ia plotëson kërkesat për transferime shkaku i buxhetit jo garues me skuadrat e tjera. Pakënaqësitë e tij janë tashmë të ditura dhe, sipas Dadebat, një rikthim për Mourinhon në Real Madrid është mundësi e madhe.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Rec Kos" Sh.p.k Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën grumbulluese dhe çmontuese të automjeteve mbeturin çmontuese të automjeteve mbeturinë, mbeturinave metalike, grumbullim të vajrave të përdorura si dhe mbeturinave nga paisjet elektrike me kode, 16, 01, 16 01 03, 16 01 04, 16 01 06, 16 01 99, 17 04, 13 01, 13 02, 16 06; 14 03, 16 08, 17 02 03, 15 02, 20 01 02, 20 01 04, 20 01 05, me etazhitet P+O në Sankovc komuna e Drenasit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.05.2023 në ora 10:00 në hapësirat Shkollës "Luigj Gurakuqi", Flamuras (Sankoc), Komuna, Drenas, do të organizohet debat publik nga Kompania "Rec Kos" Sh.p.k Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Rec Kos" Sh.p.k Fushë Kosovë për qendrën grumbulluese dhe çmontuese të automjeteve mbeturin çmontuese të automjeteve mbeturinë, mbeturinave metalike, grumbullim të vajrave të përdorura si dhe mbeturinave nga paisjet elektrike me kode, 16, 01, 16 01 03, 16 01 04, 16 01 06, 16 01 99, 17 04, 13 01, 13 02, 16 06; 14 03, 16 08, 17 02 03, 15 02, 20 01 02, 20 01 04, 20 01 05, me etazhitet P+O në Sankovc komuna e Drenasit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

## Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)

"AGRO BPRONAJ" SH.P.K. me numer Unik:812015891 me seli fshati Stanoc i Eperm p.n. Komuna Vushtrri me pronar Besart Pronaj, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për **mallrat/punët/shërbime** këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre **Makinerve, Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:**

- 1.Traktor Landini 90 HP 4x4 me kabin, klim dhe luge ngarkuese,
- 2.Mbjellese Gruri 3 m me plehrim
- 3.Mikser Fimaks 2.5 m2 me ngarkues,
- 4.Shperndarese plehut ngurt sip orion 5 ton,
- 5.Kermik transportues per Grure 10 m
- 6.Transportues per miser 8 m
- 7.Rotoballer 120x120 maschio gasardo
- 8.Kapse per Rrotoballer
- 9.Mulli me Mikser 500 kg/h elektron

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek "AGRO BPRONAJ" SH.P.K. - Besart Pronaj (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (5 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorëzimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit të ftesave** për kuotim, ofertat dorëzohen në Adresen: fshati Stanoc i Eperm p.n. Komuna Vushtrri.

Për Informata Shtesë tel: **+383 45 559 779** dhe në email adresën: **bpronaj1@gmail.com**

### Thirrje për Aplikim

Kompania: **ARTAN MAZREK B.I**

NRUI: 812015247

Adresa: Rruga Cumhuriyet, pn Mamushë

Kërkon ofertues/kompani të interesuar dhe të kualifikuar-Licensuar që të dorëzojë ofertë për projektin me titull:

**Ndërtimin e serrës së re me sipërfaqe prej 0.40 ha (4000 m<sup>2</sup>) me profile të zinguar komplek.**

Investimi në **Ndërtimin e serrës së re me sipërfaqe prej 0.40 ha (4000 m<sup>2</sup>) me profile të zinguar komplek**, do të bëhet në adresën: Rruga Cumhuriyet, pn Mamushë.

Kompanit e interesuar mund të kontaktojnë në email: [dasa-mamusa@hotmail.com](mailto:dasa-mamusa@hotmail.com) ose përmes formës fizike me zarf dhe shprehja e interesit të bëhet në adresën e lartë cekur dhe duhet të bëhet me se largu pesë (5) ditë nga data e shpalljes. Ndërsa, afati kohor për marrjen e ofertave është të paktën dhjetë (10) ditë, gjithësej pesëmbëdhjet (15) ditë janë procedurat e prokurimit.

Kompanit e interesuar, do të marrin specifikacionin dhe do të ftohen për ofertë financiare.

Kriteret e përzgjedhjes, oferta e përgjegjshme dhe me çmimin me të ulët.

**Për çdo sqarim dhe info kontaktoni në numrin:**

**+383- 044-695-698**

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besartë Faik Thaqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Albana Rraci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shme "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Mirlinda Nuhaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10,11,12 dhe diplomën certifikatën e testit të maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Enis Buqinca nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Edona Sylja nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf "Selman Riza" nga kl. I-VIII në Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 193/2023 të datës 23 Shkurt 2023, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

### VAZHDIM I KONKURSI

#### I. Zyrta për Transport 3, dy (2) vende pune

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, një (1) pozitë  
Prokuroria Themelore Mitrovicë, një (1) pozitë

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 004  
Emri pozitës: Zyrta për Transport 3  
Pozita: Pozitë e karrierës  
Niveli: Nëpunës teknik dhe mbështetës 2  
Raporton tek: Administratori i Prokurorisë  
Numri i pozitave: Dy (2) pozita  
Klasa: P 18  
Koeficienti: Tre pikë nëntë (3.9)  
Akti i emërimit: Pa afat  
Puna Provuese: Dymbëdhjetë (12) muaj  
Vendi: Prishtinë, Mitrovicë

#### Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve të transportit për prokurorë dhe stafin e Institutit.  
Kujdeset për aktivitetet e drejtpërdrejta lidhura transportin në institucion dhe mirëmbajtjen e automjeteve.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Kryen punën e vojtës së prokurorëve dhe stafit në bazë të orarit dhe caktimeve zyrtare, në nivel të prokurorisë;  
Mirëmban automjetin me të cilin kryen detyrat e punës apo me të cilin është i ngarkuar;  
Merr pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e programit në fushën e transportit dhe siguron mbarevajtjen e punëve lidhur me shërbimet e transportit;  
Është përgjegjës për sigurimin e servisimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve transportuese të institucionit;  
Mban të dhënat për përdorimin, servisimin e automjeteve dhe përgatit dokumentet e nevojshëm për përdorimin e tyre;  
Kujdeset që automjetet e institucionit të përdoren në mënyrë sa më racionale;  
Ofron shërbime të transportit sipas nevojave;  
Kryen edhe detyra tjera në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë nga mbikëqyrësi.  
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

#### Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të duhura profesionale për kryerjen e detyrës së vojtësit;  
Shkathtësi për të caktuar dhe vlerësuar punën sipas rëndësisë dhe prioriteteve;  
I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;  
Të ketë gatishmëri për kryerjen e punëve nën presion.  
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

#### Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Shkolla e Mesme, Patentë Shoferi Kategoria "B".

#### Përvoja e Punës:

Së paku 3 vite përvojë pune.

- Konkursi është i vazhduar edhe për 7 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 23.03.2023 deri me datë 29.03.2023 si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- **Aplikacionet e dërguara me postë,** të cilat mbajnë vullën postale mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 - 16:00.
- **Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**
  - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.
  - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
  - "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
- **Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuar të dokumentacionit të kërkuar:**
  - Dëshminë e kualifikimit shkollor;
  - Dëshmi mbi përvojën e punës;
  - Dëshmi e trajnimeve;
  - Dy rekomandime (nëse kenit);
  - Kopjet e dy raportave të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
  - Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
  - Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetim.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 193/2023 od 23 februar 2023. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova ponovno objavljuje:

### PRODUŽENJE KONKURSA

#### I. Službenik za Transport 3, dve (2) radnih mesta

Specijalno Tužilaštvo Republike Kosova, jedna (1) pozicija  
Osnovno Tužilaštvo Mitrovica, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 004  
Naziv pozicije: Službenik za Transport 3  
Pozicija: Pozicija karijere  
Nivo: Službenik za Tehniku i Podršku 2  
Raportira kod: Administrator Tužilaštvo  
Broj pozicija: Dve (2) pozicije  
Klasa: P 18  
Koeficient: Tri tačka devet (3.9)  
Akt imenovanja: Na neodređeno  
Probni rad: Dvanaest (12) meseci  
Mesto: Priština, Mitrovica

#### Cilj radnog mesta:

Pružanje usluga prevoza tužioca službenika i osoblja institucije. Pažljiv za direktnim aktivitetima vezana za transport u instituciju i održavanje vozila.

#### Glavne obaveze i odgovornosti:

Završava posao vozača tužilaca i službenika na osnovu rasporeda službenih odredbi na nivou tužilaštva ;

Održava vozilo sa kojim završava službene obaveze ili sa kojim je zadužen ;  
Prisutan u toku planiranja za pripremu programa na polju transporta i obezbeđuje održavanje poslova vezano za usluge transporta;

Odgovoran je za obezbeđenje servisa i održavanja transportnih vozila institucije;  
Da drži evidenciju korišćenja, servisa vozila i spremi potrebnu dokumentaciju za njihovo korišćenje ;

Stara se da vozilo institucije da se koriste na racionalan način;

Pružza usluge transporta po potrebi ;

Obavljia i druge zadatke u skladu sa aktualnim zakonima i pravilnicima koje može zatražiti od direktnog pretpostavljenog.

#### Poznavanja, spretnosti i sposobnosti za radno mesto:

Potrebno profesionalno znanje za obavljanje zadataka vozača  
Sposobnosti za određivanje i procenu posla po zadatim prioritetima  
Spreman da radi sa ljudima raznih entiteta i religija

Da je spreman za obavljanje posla pod pritiskom

Sposobnosti korišćenja računara i programa (Word, Excel, Power Point, Access, Internet)

#### Stručna sprema i Stručna sprema i kvalifikacija:

Srednja Škola, Vozačka Dozvola Kategorija „B“ .

#### Radno iskustvo:

Najmanje 3 godine radnog iskustva.

- *Konkurs je produžen za 7 (sedam) kalendarski dana od dana objavljanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 23.03.2023 do 29.03.2023 kao datum isteka konkursa.*
- *Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)*
- *Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.*
- *Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.*
- ***Aplikacije poslate putem pošte,*** koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- *U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.*
- ***Uslovi učesća na konkursu:***Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.  
Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od svojih osoba muškog i ženskog pola iz redova svojih zajednica na Kosovu.  
"Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- ***Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:***
  - Dokaz o školskoj spremi;
  - Dokaz o radnom iskustvu;
  - Dokaz o obuci;
  - Dve preporuke (ako imate);
  - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
  - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
  - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- *U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavešteni na osnovu važećeg zakonodavstva.*



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

